

LIGJ
Nr. 46/2024

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS LUBJANË–HAGË PËR BASHKËPUNIMIN
NDËRKOMBËTAR PËR HETIMIN DHE NDJEKJEN PENALE TË KRIMIT
TË GJENOCIDIT, KRIMEVE KUNDËR NJERËZIMIT, KRIMEVE TË LUFTËS
DHE KRIMEVE TË TJERA NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa Lubjanë–Hagë për Bashkëpunimin Ndërkombëtar për Hetimin dhe Ndjekjen Penale të Krimit të Gjenocidit, Krimeve kundër Njerëzimit, Krimeve të Luftës dhe Krimeve të Tjera Ndërkombëtare sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.5.2024.

Shpallur me dekretin nr. 194, datë 22.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

KONVENTA LUBJANË–HAGË
PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR PËR HETIMIN DHE NDJEKJEN PENALE
TË KRIMIT TË GJENOCIDIT, KRIMEVE KUNDËR NJERËZIMIT, KRIMEVE TË
LUFTËS DHE KRIMEVE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

Tabela e përmbajtjes

Preambula

PJESA I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Objektivi i kësaj Konvente

Neni 2. Fusha e veprimit e Konventës

Neni 3. Parime të përgjithshme të interpretimit

Neni 4. Marrëdhënia me marrëveshje të tjera

Neni 5. Përkufizimet e krimeve ndërkombëtare

Neni 6. Zbatimi opsional i kësaj Konvente

Neni 7. Kriminalizimi

Neni 8. Juridiksioni

Neni 9. Shtetasit

Neni 10. Parimi i përgjithshëm i bashkëpunimit

Neni 11. Afati i parashkrimit

Neni 12. E drejta e ankimit

Neni 13. Masa paraprake
Neni 14. *Aut dedere, aut iudicare*
Neni 15. Përgjegjësia e personave juridikë
Neni 16. Mbrojtja dhe përdorimi i të dhënave personale
Neni 17. Shkëmbimi spontan i informacionit
Neni 18. Kostot
Neni 19. Përkufizimet në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike dhe ekstradimin
PJESA II AUTORITETET QENDRORE DHE KOMUNIKIMI
Neni 20. Autoritetet qendrore
Neni 21. Rugët e komunikimit dhe pikat e vetme të kontaktit
Neni 22. Gjuhët e pranueshme
PJESA III. NDIHMA E NDËRSJELLË JURIDIKE
Neni 23. Objekti i pjesës III
Neni 24. Qëllimi i kërkesës
Neni 25. Kërkesat dhe dokumentet mbështetëse
Neni 26. Konfidencialiteti i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike
Neni 27. Masa të përkohshme
Neni 28. Informacion shtesë
Neni 29. Baza ligjore e ndihmës së ndërsjellë juridike
Neni 30. Shkaqet e refuzimit të ndihmës së ndërsjellë juridike
Neni 31. Kufizime për transmetimin dhe përdorimin e informacionit dhe provave
Neni 32. Ekzekutimi i kërkesës
Neni 33. Deponimet e personave në Shtetin Palë të kërkuar
Neni 34. Seanca dëgjimore me video konferencë
Neni 35. Paraqitja e personave në Shtetin Palë kërkuar
Neni 36. Transferimi i përkohshëm i të ndaluarve
Neni 37. Imuniteti
Neni 38. Përcjellja e objekteve, dokumenteve, të dhënave ose provave të tjera
Neni 39. Teknika hetimore të posaçme
Neni 40. Hetime në mbulim/të fshehta
Neni 41. Ekipet të përbashkëta hetimore
Neni 42. Vëzhgime ndërkufitare
Neni 43. Përgjegjësia penale e nëpunësve
Neni 44. Përgjegjësia civile e nëpunësve
Neni 45. Bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllime të konfiskimit
Neni 46. Kthimi
Neni 47. Asgjësimi i pasurive të konfiskuara, përfshirë kthimin ose ndarjen
Neni 48. Transferimi i procedimeve
PJESA IV. EKSTRADIMI
Neni 49. Objekti i pjesës IV
Neni 50. Baza ligjore për ekstradimin
Neni 51. Shkaqet e refuzimit
Neni 52. Rregulli i specialitetit
Neni 53. Riekstradimi në një Shtet të tretë
Neni 54. Ekstradimi i shtetasve
Neni 55. Ekzekutimi i kërkesës
Neni 56. Kërkesa dhe dokumentet mbështetëse
Neni 57. Konfidencialiteti i kërkesave për ekstradim
Neni 58. Kërkesa konfliktuale
Neni 59. Arresti i përkohshëm
Neni 60. Marrja parasysh e afateve të ndalimit
Neni 61. Dorëzimi i personit që do të ekstradohet
Neni 62. Dorëzimi i shtyrë ose i përkohshëm

Neni 63. Procedurat e ekstradimit të thjeshtuar

Neni 64. Dorëzimi i pronës

Neni 65. Transiti i personave që do të ekstradohen dhe transiti i personave të ekstraduar

PJESA V. TRANSFERIMI I PERSONAVE TË DËNUAR

Neni 66. Objekti i pjesës V dhe përkufizimet që lidhen me transferimin e personave të dënuar

Neni 67. Kushtet për transferim

Neni 68. Detyrimi për të dhënë informacion

Neni 69. Kërkesat, përgjigjet dhe dokumentet mbështetëse

Neni 70. Pëlqimi dhe verifikimi i tij

Neni 71. Personat që janë larguar nga Shteti Palë dënues

Neni 72. Personat e dënuar subjekt i urdhrit të dëbimit apo deportimit

Neni 73. Efekti i transferimit për Shtetin Palë dënues

Neni 74. Efekti i transferimit për Shtetin Palë administrues

Neni 75. Ekzekutimi i vazhduar

Neni 76. Konvertimi i dënimit

Neni 77. Rishikimi i vendimit gjyqësor

Neni 78. Përfundimi e ekzekutimit

Neni 79. Informacion mbi ekzekutimin

Neni 80. Transiti i personave të dënuar

PJESA VI. VIKTIMAT, DËSHMITARËT, EKSPERTËT DHE PERSONAT E TJERË

Neni 81. Përkufizimi i viktimave

Neni 82. Mbrojtja e viktimave, dëshmitarëve, ekspertëve dhe të tjerëve

Neni 83. Të drejtat e viktimave

PJESA VII. RREGULLIME INSTITUCIONALE

Neni 84. Mbledhja e Shteteve Palë

Neni 85. Mbështetja e përkohshme

PJESA VIII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 86. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 87. Ndryshime të Konventës

Neni 88. Miratimi i anekseve shtesë

Neni 89. Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

Neni 90. Hyrja në fuqi

Neni 91. Zbatim i përkohshëm

Neni 92. Rezervat

Neni 93. Tërheqja

Neni 94. Depozitari dhe gjuhët

ANEKSE

Aneksi A. Krimet e luftës

Aneksi B. Krimet e luftës

Aneksi C. Krimet e luftës

Aneksi D. Krimet e luftës

Aneksi E. Krimet e luftës

Aneksi F. Tortura

Aneksi G. Zhdukja e detyruar

Aneksi H. Krimi i agresionit

Preambula

Shtetet Palë të kësaj Konvente,

duke rikujtuar se krimet ndërkombëtare që mbulohen nga kjo Konventë janë ndër krimet më të rënda që shqetësojnë komunitetin ndërkombëtar në tërësi;

duke theksuar se lufta kundër pandëshkueshmërisë së këtyre krimeve është thelbësore për paqen, stabilitetin dhe sundimin e ligjit;

duke theksuar se Shtetet kanë përgjegjësinë kryesore për të hetuar krimet ndërkombëtare për të cilat zbatohet kjo Konventë dhe për të ndjekur penalisht autorët e dyshuar të krimeve në fjalë dhe se ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme legislative dhe ekzekutive për këtë qëllim, duke afirmuar gatishmërinë e tyre për të krijuar kushtet që lejojnë Shtetet të marrin përgjegjësi të plotë parësore;

duke u përpjekur për të ndjekur zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare në luftën kundër pandëshkueshmërisë së krimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare;

duke ripohuar të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Shteteve sipas të drejtës ndërkombëtare, sidomos të drejtës ndërkombëtare humanitare, të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare për refugjatët dhe parimin e moskthimit të parashikuar në të;

duke njohur të drejtat e viktimave, dëshmitarëve dhe të tjerëve në lidhje me krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë, rolin e rëndësishëm që ata luajnë në procesin gjyqësor dhe nevojën për të mbrojtur mirëqenien e tyre fizike dhe psikologjike dhe për të ndjekur qasjen e përqendruar të mbijetuesi, si edhe aksesin në drejtësi dhe zgjidhjen e duhur, sidomos nëpërmjet drejtësisë restauruese sipas rrethanave;

duke njohur edhe të drejtën e autorëve të dyshuar për trajtim të drejtë në të gjitha fazat e procedimit;

duke vërejtur se hetimi dhe ndjekja penale e këtyre krimeve ndërkombëtare shpesh përfshin persona të dyshuar, dëshmitarë, prova apo pasuri që ndodhen jashtë territorit të Shtetit që po kryen hetimin apo ndjekjen penale;

duke e pranuar se hetimi dhe ndjekja penale efektive e këtyre krimeve ndërkombëtare në nivel kombëtar duhet të sigurohet duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar;

duke pranuar se bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe të drejtën e brendshme është një gur themeli i përpjekjeve të vazhdueshme të Shteteve në luftën e tyre kundër pandëshkueshmërisë, dhe *duke inkurajuar* vazhdimin dhe përf forcimin e këtyre përpjekjeve në të gjitha nivelet;

duke kujtuar parimet e barazisë sovraane dhe integritetit territorial të Shteteve dhe parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të Shteteve të tjera;

duke mbajtur parasysh me kënaqësi dispozitat ekzistuese të së drejtës ndërkombëtare zakonore dhe dokumenteve shumëpalëshe që synojnë të luftojnë pandëshkueshmërinë e krimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, sidomos, inter alia, Konventën për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, Konventën e Gjenevës për Përmirësimin e gjendjes së të plagosurve dhe të të sëmurëve në Forcat e Armatosura në terren, Konventën e Gjenevës për përmirësimin e gjendjes së anëtarëve të Forcave të Armatosura të plagosur, të sëmurë dhe të mbytur në det, Konventën e Gjenevës në lidhje me Trajtimin e të burgosurve të luftës, Konventën e Gjenevës në lidhje me mbrojtjen e civilëve në kohë lufte dhe protokollat shtesë të saj, Konventën për Mbrojtjen e Pasurisë Kulturore në rast konflikti të armatosur dhe protokollat shtesë të saj, dhe Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale;

duke kujtuar se gjatë shekullit të 20-të dhe 21-të miliona njerëz kanë qenë viktime të mizorive të paimagjinueshme që kanë tronditur thellë ndërgjegjen e njerëzimit;

të vendosur për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht në mënyrë më të efektshme krimet ndërkombëtare për të cilat zbatohet kjo Konventë dhe *duke pranuar* nevojën për të forcuar kuadrin ligjor ndërkombëtar për bashkëpunim për këtë qëllim,

kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objektivi i kësaj Konvente

Objektivi i kësaj Konvente është të lehtësojë bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale ndërmjet Shteteve Palë në funksion të forcimit të luftës kundër pandëshkueshmërisë së krimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit, krimeve të luftës dhe, sipas rastit, krimeve të tjera ndërkombëtare.

Neni 2
Fusha e veprimit e Konventës

1. Shtetet Palë e zbatojnë këtë Konventë për krimet e përmendura në nenin 5.
2. Çdo Shtet Palë, në momentin e nënshkrimit, ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, apo aderimit në këtë Konventë, ose në çdo moment të mëvonshëm, mund të njoftojë Depozitarin që do të zbatojë këtë Konventë edhe për krimin ose krimet e përmendura në një nga anekset e kësaj Konvente në lidhje me çdo Shtet tjetër Palë që ka njoftuar Depozitarin se do të zbatojë Konventën për të njëjtin krim të përmendur në aneksin përkatës, i cili është pjesë e pandarë e kësaj Konvente.

Neni 3
Parime të përgjithshme të interpretimit

Asnjë parashikim i kësaj Konvente nuk do të interpretohet si i tillë që kufizon ose cenon në ndonjë mënyrë rregullat ekzistuese ose në zhvillim të së drejtës ndërkombëtare, sidomos përkufizimet për krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë.

Neni 4
Marrëdhënia me marrëveshje të tjera

Asnjë parashikim i kësaj Konvente nuk do të pengojë Shtetet Palë që kanë lidhur marrëveshje të tjera, ose që në ndonjë mënyrë kanë vendosur marrëdhënie ndërmjet tyre, në lidhje me një objekt brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, që të zbatojnë këto marrëveshje ose të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre përkatësisht, në vend të kësaj Konvente, nëse kjo lehtëson bashkëpunimin e tyre.

Neni 5
Përkufizimet e krimeve ndërkombëtare

1. Për qëllimet e kësaj Konvente “krimi i gjenocidit” do të thotë një nga veprimet e mëposhtme të kryera me qëllimin për të shkatërruar, tërësisht apo pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racor, apo fetar, si të tillë:

- a) vrasja e anëtarëve të grupit;
- b) shkaktimi i dëmtimeve të rënda trupore apo mendore tek anëtarët e grupit;
- c) keqësimi me dashje i kushteve të jetesës së grupit për të çuar në shkatërrimin e tij fizik plotësisht apo pjesërisht;

- d) vendosja e masave që kanë për synim parandalimin e lindjeve brenda grupit;
- e) transferimi me forcë i fëmijëve të grupit te një grup tjetër.

2. Për qëllime të kësaj Konvente, “krim kundër njerëzimit” do të thotë një nga veprimet e mëposhtme të kryera në kuadër të një sulmi të përhapur apo sistematik, të drejtuar ndaj civilëve, në dijeni të sulmit:

- a) vrasja;
- b) shfarosja;
- c) skllavërimi;
- d) deportimi apo transferimi me forcë i popullsisë;
- e) burgosja apo privime të tjera të rënda të lirisë fizike në shkelje të rregullave themelore të së drejtës ndërkombëtare;
- f) tortura;
- g) përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, sterilizimi i detyruar, apo çdo lloj forme tjetër e dhunës seksuale, po aq të rëndë;
- h) persekutimi i një grupi apo kolektivi të identifikueshëm, për shkaqe politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore, fetare, apo shkaqe të tjera që janë botërisht të pranueshme sipas së drejtës

ndërkombëtare, në lidhje me secilin veprim të përmendur në këtë paragraf ose çdo krim që mbulon kjo Konventë;

i) zhdukja e detyruar e personave;

j) krimi i aparteidit;

k) veprime të tjera çnjerëzore me karakter të ngjashëm të cilat me dashje shkaktojnë vuajtje të mëdha apo lëndime të rënda në trup apo në shëndetin mendor ose fizik.

3. Për qëllime të paragrafit 2:

a) “Sulm i drejtuar ndaj civilëve” do të thotë një model sjelljeje që përfshin kryerjen e shumëfishtë të veprimeve të përmendura në paragrafin 2 ndaj civilëve, në zbatim të ose për avancimin e një politike shtetërore apo organizative për kryerjen e një sulmi të tillë;

b) “Shfarosje” përfshin keqësimin me dashje të kushteve të jetesës, *inter alia*, privimin e të drejtës për ushqim dhe mjekim, të kryer me qëllimin për të shkaktuar shkatërrimin e një pjese të popullsisë;

c) “Skllavërim” do të thotë ushtrimi i ndonjë ose të gjitha tagrave që lidhen më të drejtën e pronësisë mbi një person, dhe përfshin ushtrimin e një pushteti të tillë gjatë trafikimit të personave, në veçanti të grave dhe fëmijëve;

d) “Deportim dhe transferim me forcë i popullsisë” do të thotë zhvendosje me forcë e personave të caktuar me anë të dëbimit, apo veprimeve të tjera shtrënguese nga zona ku ata ndodhen në mënyrë të ligjshme, pa shkaqe të lejuara në të drejtën ndërkombëtare;

e) “Torturë” do të thotë shkaktim me dashje i dhimbjeve apo vuajtjeve të mëdha, qoftë fizike apo mendore, ndaj një personi në burg apo nën kontrollin e të akuzuarit; përveç faktit që tortura nuk duhet të përfshijë dhimbje apo vuajtje që shkaktohen vetëm nga dënime të ligjshme, si pjesë e qenësishme e tyre ose për shkak të tyre;

f) “Shtatzëni e detyruar” do të thotë izolimi fizik i një gruaje të lënë shtatzënë me detyrim, në mënyrë të paligjshme, me qëllim për të ndikuar në përbërjen etnike të një popullsie të caktuar ose duke kryer shkelje të tjera të rënda të së drejtës ndërkombëtare. Ky përkufizim në asnjë lloj mënyre nuk do të interpretohet se ndikon te ligjet kombëtare që kanë të bëjnë me shtatzëninë;

g) “Persekutim” do të thotë privimi me dashje dhe i rëndë i të drejtave themelore në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare për arsye të identitetit të grupit apo kolektivit;

h) “Krim i aparteidit”, do të thotë veprime çnjerëzore të një karakteri të ngjashëm me ato të përmendura në paragrafin 3, të kryera në kontekstin e një regjimi të institucionalizuar të shtypjes sistematike dhe dominimit nga një grup racor mbi një ose disa grupe të tjera racore dhe të kryera me qëllim për ta ruajtur këtë regjim;

i) “Zhdukje e detyruar e personave” do të thotë arrestimi, ndalimi apo rrëmbimi i personave nga ose me autorizimin, mbështetjen apo pranimin në heshtje të Shtetit, apo të një organizate politike, të ndjekur nga refuzimi për ta pranuar këtë heqje lirie, apo për të dhënë informacion mbi fatin, apo vendndodhjen e këtyre personave, me qëllim për t’i nxjerrë jashtë mbrojtjes së ligjit për një periudhë të zgjatur kohore.

4. Për qëllime të kësaj Konvente, “krime lufte” janë:

a) Shkelje të rënda të konventave të Gjenevës të datës 12 gushtit 1949, pra, një nga veprimet e mëposhtme kundër personave apo pasurive të mbrojtura sipas dispozitave përkatëse të Konventës së Gjenevës:

i. vrasja me dashje;

ii. tortura apo trajtimi çnjerëzor, përfshirë eksperimentet biologjike;

iii. shkaktimi me dashje i vuajtjeve të mëdha apo lëndimeve të rënda në trup apo në shëndet;

iv. shkatërrimi dhe përvetësimi i pronës me shtrirje të gjerë, që nuk justifikohet nga nevoja ushtarake dhe që kryhet në mënyrë të paligjshme dhe të paprovokuar;

v. detyrimi i një të burgosuri lufte apo personave të tjerë të mbrojtur që të shërbejnë në forcat e një fuqie armiqësore;

vi. privimi me dashje i një të burgosuri lufte apo personave të tjerë të mbrojtur nga e drejta për gjykimin të drejtë dhe të rregullt;

vii. deportimi apo transferimi i paligjshëm apo izolimi fizik;

viii. pengmarrja;

b) shkelje të tjera të rënda të ligjeve dhe zakoneve të zbatueshme në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, brenda kuadrit të parashikuar të së drejtës ndërkombëtare, kryesisht, një nga veprimet e mëposhtme:

i. drejtimi me dashje i sulmeve kundër civilëve si të tillë apo kundër civilëve të veçantë që nuk janë duke marrë pjesë drejtpërdrejt në luftime;

ii. drejtimi me dashje i sulmeve kundër objekteve civile, pra objekte të cilat nuk janë objektiva ushtarakë;

iii. drejtimi me dashje i sulmeve kundër personelit, bazave të instaluara, materialeve, njësive apo mjeteve të përfshira në misione të ndihmës humanitare apo paqeruajtëse, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për sa kohë ato gëzojnë të drejtën e mbrojtjes që i është dhënë civilëve apo objekteve civile në bazë të së drejtës ndërkombëtare për konfliktet e armatosura;

iv. sulmi me dashje duke e ditur se ky sulm do të shkaktojë humbje rastësore të jetëve apo lëndim të civilëve apo dëmtime të objekteve civile, apo dëmtime të përhapura, afatgjata dhe të rënda në mjedisin natyror, të cilat mund të jenë qartazi të tepruara në raport me avantazhin e përgjithshëm ushtarak konkret dhe të drejtpërdrejtë të parashikuar;

v. sulmi ndaj apo bombardimi, me çfarëdolloj mjeti, i qyteteve, fshatrave, vendbanimeve, banesave ose ndërtesave të cilat janë të pambrojtura dhe nuk janë objektiva ushtarakë;

vi. vrasja apo plagosja e një luftëtari i cili është dorëzuar pa kushte pasi ka hedhur poshtë armët e tij, apo që nuk ka më mjete mbrojtjeje;

vii. përdorimi i papërshtatshëm i flamurit të armëpushimit, i flamurit apo i simboleve ushtarake dhe uniformës së armikut apo të Kombeve të Bashkuara, si dhe të emblemave dalluese të konventave të Gjenevës, që rezultojnë në vdekje apo lëndime të rënda të personave;

viii. transferimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga ana e fuqisë pushtuese, i pjesëve të popullatës së vet civile drejt territorit që ajo pushton, apo deportimi ose transferimi i të gjithë apo një pjese të popullsisë së territorit të pushtuar brendapërbrenda apo jashtë këtij territori;

ix. drejtimi me dashje i sulmeve kundër ndërtesave të dedikuara për fenë, arsimin, artin, shkencën apo për qëllime bamirësie, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku grumbullohen të sëmurët dhe të plagosurit, me kusht që ato të mos jenë objektiva ushtarakë;

x. nënshtrimi i personave që janë në pushtetin e një pale kundërshtare ndaj gjymtimeve fizike apo eksperimenteve mjekësore apo shkencore të çfarëdo lloji, që nuk i justifikon as trajtimi mjekësor, dentar apo spitalor i këtyre personave, dhe as nuk kryhen në interes të tyre, dhe që shkaktojnë vdekjen apo rrezikojnë rëndë shëndetin e këtyre personave;

xi. vrasja apo plagosja në pabesi e personave që i përkasin një kombi apo një ushtrie armike;

xii. deklarimi që nuk do të kursehet jeta e kundërshtarit të mundur qoftë të paaftë për të mbrojtur veten apo të dorëzuar;

xiii. shkatërrimi apo sekuestrimi i pronave të armikut, përveç rasteve kur ky shkatërrim apo sekuestrim është i domosdoshëm për nevojat e luftës;

xiv. deklarimi të pezulluara ose të papranueshme në një gjykatë i të drejtave dhe veprimeve të shtetasve të palës armiqësore të shfuqizuara;

xv. detyrimi i shtetasve të palës armiqësore për të marrë pjesë në operacionet e luftës të drejtuara kundër vendit të tyre, edhe nëse ata kanë qenë në shërbim të palës agresive përpara fillimit të luftës;

xvi. plaçkitja e një qyteti ose vendi, edhe kur merret me anë të sulmit;

xvii. përdorimi i helmit ose i armëve të helmuara;

xviii. përdorimi i gazrave asfiksuese, helmuese ose të tjera, dhe të gjitha lëngjeve, materialeve ose pajisjeve të ngjashme;

xix. përdorimi i plumbave shpërthyes ose rrafshues lehtësisht në trupin e njeriut, të tilla si plumba me mbështjellë të fortë që nuk mbulon plotësisht bërthamën ose të shpuar me prerje;

xx. fyerja ndaj dinjitetit personal, në veçanti trajtimi poshtërues dhe degradues;

xxi. përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, siç përcaktohet në paragrafin 3(f), sterilizimi i detyruar ose çdo formë tjetër e dhunës seksuale që përbën gjithashtu shkelje të rëndë të konventave të Gjenevës;

xxii. shfrytëzimi i pranisë së një civili ose personi tjetër të mbrojtur për të imunizuar disa pika, zona ose forca ushtarake nga operacionet ushtarake;

xxiii. drejtimi me dashje i sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportit, dhe personelit duke përdorur emblemat dalluese të konventave të Gjenevës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;

xxiv. përdorimi me dashje i urisë së civilëve si një metodë lufte duke i privuar ata nga objektet e domosdoshme për mbijetesën e tyre, sidomos pengimi me dashje i furnizimeve siç parashikohet në Konventat e Gjenevës;

xxv. rekrutimi ose regjistrimi i fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç në forcat e armatosura kombëtare ose përdorimi i tyre për të marrë pjesë aktive në konflikte.

c) Në rastin e një konflikti të armatosur jo të karakterit ndërkombëtar, shkelje të rënda të nenit 3 të njëjta për katër konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, përkatësisht, një nga aktet e mëposhtme të kryera kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në konflikte duke përfshirë anëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata që janë vendosur *hors de combat* për shkak të sëmundjes, plagëve, ndalimit ose ndonjë shkakut tjetër:

i. dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasje të të gjitha llojeve, gjymtim, trajtim mizor dhe torturë;

ii. fyerja ndaj dinjitetit personal, në veçanti trajtimi poshtërues dhe degradues;

iii. pengmarrja;

iv. dhënia e dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa një vendim të mëparshëm të shpallur nga një gjykatë të formuar rregullisht, duke ofruar të gjitha garancitë gjyqësore të cilat përgjithësisht njihen si të domosdoshme;

d) paragrafi 5(c) zbatohet për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar dhe kështu nuk zbatohet për situatat e trazirave dhe tensioneve të brendshme, të tilla si kryengritjet, aktet e izoluar dhe sporadike të dhunës apo akte të tjera të një natyre të ngjashme;

e) shkelje të tjera të rënda të ligjeve dhe zakoneve të zbatueshme në konfliktet e armatosura jo të karakterit ndërkombëtar, brenda kuadrit të konsoliduar të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht, ndonjë nga aktet e mëposhtme:

i. drejtimi me dashje i sulmeve kundër popullatës civile si të tillë apo kundër civilëve të veçantë që nuk janë duke marrë pjesë drejtpërdrejt në luftime;

ii. drejtimi me dashje i sulmeve kundër ndërtesave, materialeve, njësive mjekësore dhe transportit, dhe personelit duke përdorur emblemat dalluese të konventave të Gjenevës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;

iii. drejtimi me dashje i sulmeve kundër personelit, instalimeve, materialeve, njësive ose automjeteve të përfshira në ndihmë humanitare ose mision paqeruajtës në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, për sa kohë që ata kanë të drejtën e mbrojtjes që u njihet civilëve ose objekteve civile sipas të drejtës ndërkombëtare të konfliktit të armatosur;

iv. drejtimi me dashje i sulmeve kundër ndërtesave të dedikuara për fenë, arsimin, artin, shkencën apo për qëllime bamirëse, monumenteve historike, spitaleve dhe vendeve ku grumbullohen të sëmurët dhe të plagosurit, me kusht që ato të mos jenë objektiva ushtarake;

v. plaçkitja e një qyteti ose vendi, edhe kur merret me anë të sulmit;

vi. përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënia e detyruar, siç përcaktohet në paragrafin 3(f), sterilizimi i detyruar ose çdo formë tjetër e dhunës seksuale që përbën gjithashtu shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët për të katër konventat e Gjenevës;

vii. rekrutimi ose regjistrimi i fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç në forcat e armatosura ose grupe apo përdorimi i tyre për të marrë pjesë aktive në konflikte;

viii. urdhërimi i zhvendosjes së popullatës civile për arsye që lidhen me konfliktin, përveçse kur këtë e kërkon siguria e civilëve të përfshirë ose arsye të domosdoshme ushtarake;

ix. vrasja ose plagosja me pabesi e një kundërshtari luftarak;

x. deklarimi që nuk do të kursehet jeta e kundërshtarit të mundur qoftë të paafte për të mbrojtur veten apo të dorëzuar;

xi. nënshtrimi i personave që janë në pushtetin e një pale tjetër në konflikt ndaj gjymtimeve fizike apo eksperimenteve mjekësore apo shkencore të çfarëdo lloji, që nuk i justifikon as trajtimi mjekësor, dentar apo spitalor i këtyre personave, dhe as nuk kryhen në interes të tyre, dhe që shkaktojnë vdekjen apo rrezikojnë rëndë shëndetin e këtyre personave;

xii. shkatërrimi ose sekuestrimi i pronës së një kundërshtari, përveçse kur ky shkatërrim ose sekuestrim kërkohet me detyrim nga nevojat e konfliktit;

f) paragrafi 4(e) zbatohet për konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar dhe prandaj nuk zbatohet për situatat e trazirave dhe tensioneve të brendshme, të tilla si kryengritjet, aktet e izoluar dhe sporadike të dhunës apo akte të tjera të një natyre të ngjashme. Ai zbatohet për konfliktet e armatosura që ndodhin në territorin e një Shteti kur ka konflikt të armatosur të zgjatur midis autoriteteve shtetërore dhe grupeve të armatosura të organizuara ose mes këtyre grupeve.

5. Asnjë parashikim në paragrafin 5(c) dhe (e) nuk prek përgjegjësinë e Qeverisë për të ruajtur ose për të rivendosur ligjin dhe rendin në Shtet ose për të mbrojtur unitetin dhe integritetin territorial të Shtetit, me anë të të gjitha mjeteve të ligjshme.

6. Për qëllime të kësaj Konvente, krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë nuk do të konsiderohen krime politike, krime të lidhura me një krim politik apo krime të frymëzuara nga motive politike.

Neni 6

Zbatimi opsional i kësaj Konvente

Shtetet Palë, pa cenuar nenet 2 dhe 3, mund të bien dakord të zbatojnë këtë Konventë për çdo kërkesë që i referohet aktit kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) akti është krim gjenocidi, krim kundër njerëzimit, krim lufte, krim agresioni, torturë ose zhdukje e detyruar sipas të drejtës ndërkombëtare;

b) akti është krim gjenocidi, krim kundër njerëzimit, krim lufte, krim agresioni, torturë ose zhdukje e detyruar sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë kërkuar;

c) akti është veprë penale e ekstradueshme sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar.

Neni 7

Kriminalizimi

1. Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për t'u siguruar që krimet për të cilat Shteti Palë zbaton këtë Konventë të përbëjnë krime sipas të drejtës së tij penale.

2. Krimet e përmendura në paragrafin 1 çdo Shtet Palë i bën të ndëshkueshme me dënime të përshtatshme që marrin parasysh rëndesën e tyre.

Neni 8

Juridiksioni

1. Çdo Shtet Palë merr masa që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë në përputhje me nenin 2, paragrafi 1, sikurse dhe çdo krim që ka njoftuar si të zbatueshëm sipas nenit 2, paragrafi 2, në rastet e mëposhtme:

a) kur krimet janë kryer në cilindo territor nën juridiksionin e tij, apo në bordin e një anijeje apo mjeti fluturues të regjistruar në atë Shtet;

b) kur autori i dyshuar për kryerjen e veprës penale është shtetas i atij Shteti.

2. Çdo Shtet Palë mund të marrë masat që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë në përputhje me nenin 2, paragrafi 1, si edhe çdo krim që ka njoftuar si të zbatueshëm sipas nenit 2, paragrafi 2, në rastet e mëposhtme:

a) kur autori i dyshuar është person pa shtetësi me qëndrim të zakonshëm në territorin e atij shteti;

b) kur viktima është shtetas i atij Shteti;

3. Po kështu çdo Shtet Palë merr masat që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi këto krime në rastet kur autori i dyshuar ndodhet në cilindo territor nën juridiksionin e tij dhe nuk e ekstradon autorin e dyshuar në ndonjë prej Shteteve të përmendura në paragrafët 1 ose 2, ose nuk e dorëzon autorin e dyshuar te një gjykatë ose tribunal penal ndërkombëtar.

4. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar në përputhje me të drejtën e brendshme.

Neni 9
Shtetasit

Për qëllimet e kësaj Konvente, çdo Shtet Palë, në çdo moment, me njoftim me shkrim drejtuar Depozitarit, mund të përkufizojë termin “shtetas” sipas të drejtës së tij të brendshme.

Neni 10
Parimi i përgjithshëm i bashkëpunimit

Shtetet Palë ekzekutojnë kërkesat për bashkëpunim të bëra sipas kësaj Konvente në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

Neni 11
Afati i parashkrimit

Për qëllimet e kësaj Konvente, krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë, në përputhje me nenin 2, nuk do të jenë objekt i afatit të parashkrimit ndryshe nga e drejta ndërkombëtare.

Neni 12
E drejta e ankimit

1. Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për t’u siguruar që çdo person që pretendon se janë kryer ose po kryhen krimet për të cilat ai Shtet Palë zbaton këtë Konventë, ka të drejtën e ankimit tek autoritetet kompetente.

2. Shtetet Palë marrin përsipër të shqyrtojnë, menjëherë dhe në mënyrë të paanshme, çdo ankim të marrë, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe, sipas rastit, politikat e brendshme përkatëse.

Neni 13
Masa paraprake

1. Çdo Shtet Palë, në territorin e të cilit ndodhet një person i cili dyshohet se ka kryer një krim për të cilin zbatohet kjo Konventë, pasi të bindet dhe pasi të ketë shqyrtuar informacionin në dispozicion të tij se kjo përlligjet nga rrethanat, e ndalon atë person ose merr masa të tjera ligjore për të siguruar praninë e tij në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm. Ndalimi dhe masat e tjera ligjore duhet të vazhdojnë vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për të mundësuar fillimin e procedimit penal, ekstradimit apo dorëzimit.

2. Shteti Palë në fjalë kryen menjëherë një hetim paraprak lidhur me faktet.

3. Çdo personi të ndaluar sipas paragrafit 1 i jepet ndihmë që të komunikojë menjëherë me përfaqësuesin më të afërt të përshtatshëm të Shtetit të tij, ose nëse ai është person pa shtetësi, me përfaqësuesin e Shtetit ku ka qëndrimin e zakonshëm.

4. Kur një Shtet Palë, në përputhje me këtë nen, ka ndaluar një person, ai njofton menjëherë Shtetet Palë të përmendura në nenin 8, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, për faktin që ky person është i ndaluar dhe rrethanat të cilat përlligjin ndalimin e personit. Shteti Palë që bën hetimin paraprak të parashikuar në paragrafin 2 i raporton menjëherë gjetjet e tij te Shtetet Palë në fjalë dhe tregon nëse ai synon të ushtrojë juridiksionin.

Neni 14
Aut dedere, aut iudicare

1. Nëse në rastet e përcaktuara në nenin 8, Shteti Palë në territorin nën juridiksionin e të cilit ndodhet personi i dyshuar për kryerjen e një prej krimeve për të cilat zbatohet kjo Konventë në përputhje me nenin 2, nuk e ekstradon apo e dorëzon personin te një Shtet tjetër apo te një gjykatë ose tribunal

kompetent ndërkombëtar, ai ia paraqet çështjen autoriteteve të veta kompetente për qëllim të ndjekjes penale.

2. Këto autoritete e marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e çdo krimi tjetër të një natyre të rëndë sipas legjislacionit të brendshëm të atij Shteti Palë. Në rastet e përmendura në nenin 8, paragrafi 3, standardet e provës të nevojshme për ndjekjen penale dhe dënimin në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë më pak të rrepta se ato që zbatohen për rastet e përmendura në nenin 8, paragrafi 1 dhe paragrafi 2.

3. Çdo personi ndaj të cilit ka filluar procedimi në lidhje me një prej krimeve për të cilat zbatohet kjo Konventë do t'i garantohet trajtim i drejtë në të gjitha fazat e procedimit.

Neni 15

Përgjegjësia e personave juridikë

1. Çdo Shtet Palë merr masat që mund të jenë të nevojshme në përputhje me parimet e tij ligjore për të përcaktuar përgjegjësinë e personave juridikë për pjesëmarrjen e tyre në krime për të cilat ai Shtet Palë e zbaton këtë Konventë.

2. Sipas parimeve ligjore të një Shteti Palë, përgjegjësia e personave juridikë mund të jetë penale, civile apo administrative.

3. Kjo përgjegjësi nuk cenon përgjegjësinë penale të personave fizikë që kanë kryer krimet.

4. Në veçanti, çdo Shtet Palë sigurohet që personat juridikë që kanë përgjegjësi në përputhje me këtë nen t'i nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale dhe frenuese penale ose jo penale, përfshirë sanksionet monetare.

Neni 16

Mbrojtja dhe përdorimi i të dhënave personale

1. Shtetet Palë sigurohen që të dhënat personale të transferuara nga një Shtet Palë te një tjetër të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë transferuar. Të dhënat personale nuk do të përdoren për ndonjë qëllim të papajtueshëm. Të dhënat personale nuk do të transferohen te ndonjë Shtet i tretë ose organizatë ndërkombëtare pa miratimin paraprak të Shtetit Palë që ka transferuar fillimisht të dhënat personale. Shteti Palë që ka transferuar fillimisht të dhënat personale mund të specifikojë termat që Shteti Palë kërkues duhet të respektojë në lidhje me çdo transferim të mëtejshëm.

2. Nëse Shteti Palë i kërkuar ka vendosur kushte të veçanta për përdorimin e të dhënave personale që ka dhënë, Shteti Palë kërkues, me kërkesë të Shtetit Palë të kërkuar, jep informacionin për përdorimin e të dhënave personale.

3. Nëse Shteti Palë i kërkuar, pasi t'i ketë dhënë të dhënat Shtetit Palë kërkues, vihet në dijeni të rrethanave që mund të bëjnë që ai të kërkojë një kusht shtesë në një rast të caktuar, autoriteti qendror i Shtetit Palë të kërkuar mund të konsultojë autoritetin qendror të Shtetit Palë kërkues që të përcaktojë masën deri ku mund të mbrohen të dhënat personale.

4. Shtetet Palë i transferojnë njëra-tjetrës të dhëna personale të sakta. Nëse duket se janë transferuar të dhëna personale jo korrekte ose nëse duket se të dhënat personale nuk duhej të ishin transferuar nga Shteti Palë kërkues ose i kërkuar, Shteti Palë në fjalë njoftohet menjëherë për këtë qëllim. Shteti Palë në fjalë korrigjon ose fshin të dhënat personale pa vonesë, përveçse kur nuk është e nevojshme për qëllimet e paragrafëve 8 dhe 9.

5. Me kërkesë, personi në fjalë informohet për çdo të dhënë personale të transferuar në lidhje me atë person dhe për qëllimin e përdorimit të tij të destinuar. Megjithatë, ky informacion mund të mos tregohet për të shmangur cenimin e parandalimit, zbulimit, hetimit ose ndjekjes penale të krimeve.

6. Të dhënat personale të transferuara fshihen ose anonimizohen nga Shteti Palë kërkues sapo nuk kërkohen më për qëllimin për të cilin janë transferuar, përveçse kur mbajtja e të dhënave personale kërkohet për të ushtruar të drejtat e përmendura në paragrafët 8 dhe 9.

7. Shteti Palë marrës sigurohet që të dhënat personale të marra të mbrohen nga humbja aksidentale, shkatërrimi aksidental ose i paligjshëm ose tjetërsimi dhe nxjerrja pa autorizim, aksesit pa autorizim dhe çdo përpunim tjetër i paautorizuar.

8. Për qëllimet e kësaj Konvente, Shtetet Palë sigurohen që çdo person për të cilin bëhet transferimi i të dhënave të ketë të drejtë akses, korrigjimi ose fshirjeje të të dhënave personale nga Shteti Palë që ka përcjellë të dhënat ose nga Shteti Palë që ka marrë të dhënat. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të kufizohet nëse do të përbënte një prej qëllimeve të përmendura në paragrafin 1 ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive të personave të tjerë.

9. Shtetet Palë sigurohen që personat e prekur të kenë të drejtë të kërkojnë zgjidhje të efektshme për shkeljen e çdo detyrimi që përmban ky nen.

10. Shteti Palë i kërkuar nuk është i detyruar të transferojë të dhëna personale nëse legjislacioni i brendshëm që zbatohet për këtë qëllim e ndalon transferimin ose nëse ka arsye të supozojë se interesat e ligjshme të personit në fjalë do të ndikoheshin negativisht nga ky transferim.

Neni 17

Shkëmbimi spontan i informacionit

1. Një Shtet Palë, pa cenuar legjislacionin e tij të brendshëm, pa kërkesë paraprake, mund të përcjellë informacion në lidhje me krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë te një Shtet tjetër Palë kur ai beson se ky informacion mund të ndihmojë Shtetin Palë marrës që të ndërmarrë ose të përfundojë me sukses hetimin dhe procedimin penal ose mund të rezultojë në një kërkesë të formuluar nga Shteti Palë marrës në përputhje me këtë Konventë. Pa cenuar kushtet më të favorshme në dokumente të tjera ligjore, shkëmbimi spontan i informacionit bëhet përmes autoriteteve kompetente të Shtetet Palë në fjalë.

2. Përcjellja e informacionit sipas paragrafit 1 nuk cenon hetimin dhe ndjekjen penale në Shtetin Palë dhënës.

3. Autoritetet kompetente marrëse të informacionit respektojnë kërkesën e Shtetit Palë dhënës që informacioni të jetë konfidencial, edhe përkohësisht, ose me kufizime për përdorimin e tij.

4. Shteti Palë marrës, pavarësisht paragrafit 3, në proceset e tij mund të nxjerrë informacion që shfaqëson një person të akuzuar. Në këtë rast, Shteti Palë marrës njofton Shtetin Palë dhënës përpara nxjerrjes së informacionit, dhe nëse kërkohet, konsultohet me Shtetin Palë dhënës. Nëse, në raste përjashtimore, njoftimi paraprak nuk është i mundur, Shteti Palë marrës informon Shtetin Palë dhënës për nxjerrjen e informacionit pa vonesë.

5. Me kërkesë të Shtetit Palë dhënës informacioni i përcjellë nuk do të përdoret si provë në procedime penale përpara se të miratohet kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike.

Neni 18

Kostot

1. Kostot e zakonshme të ekzekutimit të një kërkesë në zbatim të kësaj Konvente do të mbulohen nga Shteti Palë i kërkuar, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe në këtë Konventë ose rënë dakord ndryshe nga Shtetet Palë të interesuara. Nëse për të përmbushur kërkesën janë apo do të jenë të nevojshme shpenzime të një natyre thelbësore apo të jashtëzakonshme, Shtetet Palë konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa dhe mënyrën se si do të mbulohen shpenzimet.

2. Kostot e mëposhtme mbulohen ose rimbursohen nga Shteti Palë kërkuar, përveçse kur Shteti Palë i kërkuar heq dorë nga rimbursimi i të gjitha ose i një pjese të shpenzimeve:

a) kostot e kryera për praninë e ekspertëve në territorin e Shtetit Palë të kërkuar;

b) kostot për vendosjen dhe mirëmbajtjen e lidhjeve telefonike ose video;

c) shpërblimi i përkthyesve të siguruar nga Shteti Palë i kërkuar;

d) shpërblimet për dëshmitarët si edhe për shpenzimet e tyre për udhëtim dhe ushqim në territorin e Shtetit Palë të kërkuar.

3. Kostot për transportimin në Shtetin Palë kërkuar të një personi të ndaluar të kryera sipas nenit 36 të kësaj Konvente mbulohen nga Shteti Palë kërkuar.

4. Kostot për transportimin në Shtetin Palë kërkuar të personit për të cilin kërkohet ekstradimi mbulohen nga Shteti Palë kërkuar.

5. Kostot për transportimin e personit të dënuar në Shtetin Palë administrues që ekzekuton dënimin e tij mbulohen nga ai Shtet Palë.

Neni 19

Përkufizimet në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike dhe ekstradimin

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “Konfiskim” që sipas rastit përfshin sekuestrimin, është marrja e përhershme e pronës me urdhër të një gjykate ose autoriteti tjetër kompetent.

b) “Ngrirje” ose “sekuestrim” është ndalimi i përkohshëm i transferimit, shndërrimit, shitjes ose lëvizjes së pronës ose marrja përkohësisht në kujdestari ose në kontroll e pronës bazuar në një urdhër të lëshuar nga një gjykatë ose organ tjetër kompetent;

c) “Të ardhura nga krimi” është çdo pasuri që rrjedh ose sigurohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga kryerja e një vepre penale;

d) “Pronë” është pasuria e çdo lloji, qoftë materiale ose jo materiale, e luajtshme ose e paluajtshme, e prekshme apo e paprekshme dhe dokumente ose instrumente ligjore që vërtetojnë titullin e këtyre pasurive, ose interesin për këto pasuri.

PJESA II

AUTORITETET QENDRORE DHE KOMUNIKIMI

Neni 20

Autoritetet qendrore

1. Çdo Shtet Palë cakton një ose më shumë autoritete qendrore. Autoritetet qendrore janë përgjegjëse për të dërguar dhe pranuar kërkesat dhe informacionin për bashkëpunim në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe inkurajon ekzekutimin e shpejtë dhe të duhur të kërkesave nga autoritetet kompetente.

2. Kur një Shtet Palë ka një rajon apo territor të posaçëm me një sistem të veçuar për bashkëpunimin sipas kësaj Konvente, ai mund të caktojë një autoritet qendror të veçantë që do të ketë funksionet e përmendura në paragrafin 1 për atë rajon apo territor.

3. Kur një Shtet Palë ka një autoritet qendror të veçantë përgjegjës për të dërguar dhe marrë kërkesa dhe informacion në përputhje me dispozitat specifike të kësaj Konvente, ai mund të caktojë një autoritet qendror të veçantë që do të ketë funksionet e përmendura në paragrafin 1 për dispozitat përkatëse të kësaj Konvente.

4. Me kërkesë të një ose më shumë Shteteve Palë, mes autoriteteve qendrore mund të zhvillohen konsultime për çështje që lidhen me zbatimin e kësaj Konvente.

5. Çdo Shtet Palë me anë të një deklarate drejtuar Depozitarit, e njofton këtë të fundit për caktimin e një ose më shumë autoriteteve qendrore sipas paragrafit 1, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo të aderimit në këtë Konventë. Rrjedhimisht, Shteti në çdo kohë dhe në të njëjtën mënyrë, mund të ndryshojë kushtet e deklaratës së tij.

Neni 21

Rrugët e komunikimit dhe pikat e vetme të kontaktit

1. Kërkesat e bëra në përputhje me këtë Konventë dhe çdo komunikim i lidhur me të i përcillen autoriteteve qendrore të caktuara nga Shtetet Palë.

2. Çdo Shtet Palë, në momentin e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në çdo moment të mëvonshëm, mund të deklarojë me anë të një komunikate drejtuar Depozitarit, që kërkesat t'i drejtohen atij përmes rrugëve diplomatike, dhe/ose nëse është e mundur, përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale.

3. Për të lehtësuar komunikimin e efektshëm në lidhje me ekzekutimin e një kërkesë individuale të bërë në përputhje me këtë Konventë, çdo Shtet Palë, pa cenuar nenin 20, paragrafi 1 deri në paragrafin

4, mund të caktojë një pikë të vetme kontakti brenda autoriteteve të tij kompetente. Këto pika kontakti mund të ndërliidhen me njëra-tjetrën për çështje praktike në lidhje me ekzekutimin e një kërkesë të tillë.

4. Çdo Shtet Palë tregon pikat e tij të vetme të caktuara të kontaktit në përputhje me nenin 85, paragrafi 1.

5. Përcjellja e çdo kërkesë, informacioni ose komunikimi bazuar në këtë Konventë, nëse Shtetet Palë në fjalë bien dakord, mund të bëhet me mjete të sigurta elektronike duke pasur parasysh nevojën për të mbrojtur konfidencialitetin dhe për të siguruar autenticitetin. Në çdo rast, me kërkesë dhe në çdo moment, Shteti Palë në fjalë paraqet kopjet origjinale ose autentike të dokumentit.

Neni 22

Gjuhët e pranueshme

1. Kërkesat do të bëhen në gjuhë të pranueshme për Shtetin Palë të kërkuar.

2. Çdo Shtet Palë do të tregojë gjuhën ose gjuhët e pranueshme për atë Shtet duke njoftuar autoritetet qendrore të Shteteve Palë ose, nëse plotësohen kushtet në nenin 85, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, Shtetin e caktuar për të dhënë mbështetje të përkohshme shtesë.

PJESA III

NDIHMA E NDËRSJELLË JURIDIKE

Neni 23

Objekti i pjesës III

1. Shtetet Palë duhet t'i japin njëra-tjetrës masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë juridike për hetimet, ndjekjet penale apo proceset gjyqësore, në lidhje me krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë.

2. Ndihma e ndërsjellë juridike do të ofrohet në masën më të plotë të mundshme sipas ligjeve, traktateve, marrëveshjeve dhe rregullimeve të Shtetit Palë të kërkuar, lidhur me hetimet, ndjekjet penale dhe proceset gjyqësore në lidhje me krime për të cilat një person juridik mund të ketë përgjegjësi penale në Shtetin Palë kërkuar, sipas nenit 15, paragrafi 1.

Neni 24

Qëllimi i kërkesës

Ndihma e ndërsjellë juridike që duhet të jepet në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të përfshijë:

- a) marrjen e provave apo deklarimeve nëpërmjet video-konferencës, sa kohë që kjo është në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar;
- b) këqyrjen e objekteve dhe vendeve;
- c) dhënien e informacionit, sendeve provuese dhe raporteve të ekspertëve;
- d) kryerjen e kontrolleve, sekuestreimeve dhe konfiskimeve;
- e) kryerjen e njoftimit të dokumenteve gjyqësore;
- f) vënien në dispozicion të kopjeve origjinale apo kopjeve të njësuar të dokumenteve nëse është nevojë, të dokumenteve përkatëse, të rekordeve dhe të të dhënave kompjuterike, përfshirë të dhënat zyrtare, bankare, financiare, të kompanive apo bizneseve;
- g) lehtësimin e paraqitjes me dëshirë të personave dhe transferimit të përkohshëm të personave të ndaluar në Shtetin Palë kërkuar;
- h) përdorimin e teknikave hetimore të posaçme;
- i) kryerjen e vëzhgimeve ndërkuftare;
- j) krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore;
- k) marrjen e masave që mundësojnë mbrojtjen e duhur të viktimave dhe dëshmitarëve dhe të të drejtave të tyre;
- l) dhënien e çdo lloj ndihme tjetër që nuk është në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar.

Neni 25

Kërkesat dhe dokumentet mbështetëse

1. Kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike bëhet me shkrim sipas kushteve që e lejojnë Shtetin Palë të kërkuar të provojë autenticitetin.
2. Kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike përmban ose shoqërohet me sa më poshtë:
 - a) identitetin e autoritetit që bën kërkesën;
 - b) objektin dhe natyrën e hetimit, ndjekjes penale, apo procesit gjyqësor, me të cilën lidhet kërkesa, si dhe emrin dhe funksionet e autoritetit që kryen hetimin, ndjekjen penale apo procesin gjyqësor;
 - c) një përmbledhje të fakteve përkatëse, me përjashtim të rasteve në lidhje me kërkesat për qëllim të njoftimit të dokumenteve gjyqësore;
 - d) parashikimin e legjislacionit të brendshëm përkatës, të shoqëruar me tekste referimi dhe një parashikim për dënimin që është vendosur ose mund të vendoset për krimet;
 - e) një përshkrimi i ndihmës së kërkuar dhe detaje të çfarëdolloj procedure të veçantë që Shteti Palë kërkuar dëshiron që të ndiqet;
 - f) kur është e mundur, identitetin, vendndodhjen dhe kombësinë e çdo personi në fjalë;
 - g) qëllimet për të cilat kërkohet prova, informacioni apo veprimi dhe kur është e nevojshme rëndësinë e tyre për hetimin, ndjekjen penale ose procesin gjyqësor bazë;
 - h) sipas rastit, afatin brenda të cilit duhet të jepet ndihma dhe arsyet përkatëse;
 - i) kur është e mundur, një parashikim të legjislacionit të brendshëm përkatës që lejon dëshmitarin të refuzojë të japë dëshminë.
3. Në rrethana urgjente, kur është rënë dakord nga Shteti Palë kërkuar dhe Shteti Palë i kërkuar, kërkesat mund të bëhen me gojë ose me çdo mjet që le gjurmë me shkrim, por duhet të konfirmohen në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 sapo të jetë e mundur.

Neni 26

Konfidencialiteti i kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike

Shteti Palë i kërkuar mban konfidencial faktin, thelbin dhe rezultatin e kërkesës, përveçse në masën e nevojshme për të ekzekutuar kërkesën. Nëse Shteti Palë i kërkuar nuk mund të përmbushë kërkesën për konfidencialitet, ai njofton menjëherë Shtetin Palë të kërkuar. Shteti Palë kërkuar vendos nëse kërkesa gjithsesi duhet të ekzekutohet.

Neni 27

Masa të përkohshme

1. Shteti Palë i kërkuar, me kërkesë të Shtetit Palë kërkuar, në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, mund të marrë masa të përkohshme për qëllim të ruajtjes së provave, ruajtjes së një situate ekzistuese ose mbrojtjes së interesave të ligjshme të rrezikuara.
2. Shteti Palë i kërkuar mund të ekzekutojë kërkesën për masa të përkohshme, pjesërisht ose sipas disa kushteve, përfshirë kufizimin e kohëzgjatjes së masave të kërkuara.

Neni 28

Informacion shtesë

Nëse Shteti Palë i kërkuar vlerëson se informacioni i dhënë në mbështetje të kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike nuk është i mjaftueshëm për marrë një vendim apo për të mundësuar ekzekutimin e kërkesës, mund të kërkojë që të jepet informacion shtesë brenda një kohe të arsyeshme të përcaktuar prej tij.

Neni 29

Baza ligjore e ndihmës së ndërsjellë juridike

Nëse një Shtet Palë që e kushtëzon ndihmën e ndërsjellë juridike me ekzistencën e një traktati merr një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike nga një tjetër Shtet Palë me të cilin nuk ka marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike, ai duhet të konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ndihmën e ndërsjellë juridike në lidhje me çdo krim për të cilin zbatohet kjo Konventë.

Neni 30

Shkaqet e refuzimit të ndihmës së ndërsjellë juridike

1. Ndihma e ndërsjellë juridike, duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në paragrafin 2, mund të refuzohet nëse:

a) Shteti Palë i kërkuar ka shkaqe thelbësore për të besuar që kërkesa është bërë për qëllim të ndjekjes penale ose dënimit të një personi për shkak të racës, seksit, orientimit seksual, fesë, kombësisë, origjinës etnike, opinioneve politike ose përkatësisë në një grup të caktuar social, ose që përmbushja e kërkesës do të cenonte pozitën e atij personi për ndonjë prej këtyre shkaqeve;

b) Kërkesa ka të bëjë me një krim të dënueshëm me dënim me vdekje sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë kërkuar, përveçse kur, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar.

i. Shteti Palë kërkuar jep garanci të besueshme, të mjaftueshme dhe të efektshme ose, nëse kërkohet nga Shteti Palë i kërkuar, bie dakord për një kusht, që plotëson kërkesat e Shtetit Palë të kërkuar, që dënimi me vdekje nuk do të vendoset; ose

ii. kur është e mundur sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar, nëse është dhënë tashmë dënimi me vdekje, Shteti Palë kërkuar jep garanci të besueshme, të mjaftueshme dhe të efektshme, ose, nëse kërkohet nga Shteti Palë i kërkuar, bie dakord për një kusht që plotëson kërkesat e Shtetit Palë të kërkuar, që dënimi me vdekje nuk do të ekzekutohet;

c) Kërkesa ka të bëjë me fakte mbi bazën e të cilave personi i ndjekur penalisht është gjykuar përfundimisht në Shtetin Palë të kërkuar për një krim bazuar në të njëjtën sjellje kriminale;

d) Ka shkaqe thelbësore për të besuar që personi objekt i kërkesës do t'i nënshtrohej torturës ose trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, një shkeljeje flagrante të të drejtës për gjykim të drejtë ose shkeljeve të tjera flagrante të të drejtave themelore të njeriut në Shtetin Palë kërkuar në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar;

e) Autoritetet e Shtetit Palë të kërkuar do të ndalohehin nga legjislacioni i brendshëm për të kryer veprimin e kërkuar në lidhje me çdo krim të ngjashëm bazuar në të njëjtën sjellje kriminale, nëse ai do t'i nënshtrohej hetimit, ndjekjes penale ose proceseve gjyqësore nën juridiksionin e tyre;

f) Kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente;

g) Shteti Palë i kërkuar konsideron që ekzekutimi i kërkesës ka gjasa të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësore;

h) Kërkesa është bërë në emër të një gjykate ose tribunali të jashtëzakonshëm ose *ad hoc* të Shtetit Palë kërkuar, përveçse kur autoritetet kompetente të Shtetit Palë kërkuar japin garancitë e konsideruara të mjaftueshme që vendimi do të jepet nga një gjykatë e cila përgjithësisht ka kompetencë që të shprehet për çështje penale, sipas rregullave të administrimit gjyqësor.

i) Miratimi i kërkesës do të ishte në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar në lidhje me ndihmën e ndërsjellë juridike;

j) Ka shkaqe thelbësore për të besuar se personi objekt i kërkesës do të përballej me rrezikun real të dënimit me burgim të përjetshëm pa të drejtë lrimi me kusht ose të dënimit pa afat të caktuar.

2. Shtetet Palë, gjatë ushtrimit të diskrecionit sipas paragrafit 1, marrin parasysh parimet ndërkombëtare dhe të brendshme të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, sidomos të drejtën për të jetuar, lirinë dhe sigurinë e personit.

3. Shtetet Palë nuk mund të refuzojnë një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike për shkakun e vetëm që krimi gjithashtu konsiderohet se përfshin çështje financiare, as për shkak të sekretit bankar.

4. Për çdo refuzim ose refuzim të pjesshëm për ndihmë të ndërsjellë juridike do të jepen arsye.

5. Përpara refuzimit të një kërkesë sipas këtij neni, ose shtyrjes së ekzekutimit të saj sipas nenit 32 paragrafi 4, Shteti Palë i kërkuar konsultohet, sipas rastit, me Shtetin Palë kërkuar për të marrë parasysh

nëse ndihma mund të ofrohet sipas termave dhe kushteve që i konsideron të nevojshme. Nëse Shteti Palë kërkesues pranon ndihmën sipas këtyre kushteve, ai i përmbush kushtet.

Neni 31

Kufizime për transmetimin dhe përdorimin e informacionit dhe provave

1. Shteti Palë kërkesues, pa marrë pëlqimin paraprak të Shtetit Palë të kërkuar, nuk transmeton apo përdor informacion ose prova të siguruar nga Shteti Palë i kërkuar për hetimet, ndjekjet penale ose proceset gjyqësore, përveç atyre të shprehura në kërkesë.

2. Asnjë parashikim i këtij neni nuk pengon Shtetin Palë kërkesues që në procese të nxjerrë informacionin ose provat që shfaqësojnë një person të akuzuar. Në rastin e fundit, Shteti Palë kërkesues njofton Shtetin Palë të kërkuar përpara nxjerrjes së informacionit dhe, nëse kërkohet, konsultohet me Shtetin Palë të kërkuar. Nëse, në një rast përjashtimor, nuk është i mundur njoftimi paraprak, Shteti Palë kërkesues informon pa vonesë Shtetin Palë të kërkuar për nxjerrjen e informacionit.

3. Nëse Shteti Palë i kërkuar ka vendosur kushte të veçanta për përdorimin e informacionit ose të provave që ka dhënë, Shteti Palë kërkesues, me kërkesë të Shtetit Palë të kërkuar, jep informacionin për përdorimin e të dhënave personale.

4. Nëse Shteti Palë i kërkuar, pasi t'i ketë dhënë të dhënat Shtetit Palë kërkesues, vihet në dijeni të rrethanave që mund të bëjnë që ai të kërkojë një kusht shtesë në një rast të caktuar, autoriteti qendror i Shtetit Palë të kërkuar mund të konsultohet me autoritetin qendror të Shtetit Palë kërkesues që të përcaktojë masën deri ku mund të mbrohet informacioni dhe provat.

Neni 32

Ekzekutimi i kërkesës

1. Kërkesa ekzekutohet në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar dhe në masën që ajo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar, dhe kur është e mundur, në përputhje me procedurat e specifikuar në kërkesë.

2. Shteti Palë i kërkuar e ekzekuton kërkesën sa më shpejt të jetë e mundur dhe merr parasysh sa më shumë të jetë e mundur çdo afat të sugjeruar nga Shteti Palë kërkesues, dhe për të cilat janë dhënë arsye, më së miri në kërkesë. Ai i përgjigjet kërkesave të arsyeshme të Shtetit Palë kërkesues për ecurinë e trajtimit të kërkesës. Shteti Palë kërkesues njofton menjëherë Shtetin Palë të kërkuar kur ndihma e kërkuar nuk është më e nevojshme.

3. Bazuar në kërkesën e shprehur të Shtetit Palë kërkesues, Shteti Palë i kërkuar, aq sa është e mundur, tregon datën dhe vendin e ekzekutimit të kërkesës për ndihmë të ndërsjellë juridike. Nëpunësit dhe personat e interesuar mund të jenë të pranishëm nëse Shteti Palë i kërkuar ka dhënë pëlqimin.

4. Shteti Palë i kërkuar mund të shtyjë ekzekutimin e kërkesës me arsyen që ajo ndërhyr në një hetim, ndjekje penale apo proces gjyqësor në proces. Sipas rastit, jepen arsye për çdo shtyrje sidomos, kur është e mundur, kushtet në të cilat dhe afatet brenda të cilave mund të bëhet ekzekutimi.

Neni 33

Deponimet e personave në Shtetin Palë të kërkuar

1. Dëshmitarët dhe ekspertët do të dëgjohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar. Dëshmitarët dhe ekspertët mund të refuzojnë të japin dëshminë e tyre nëse këtë ua lejon legjislacioni i Shtetit Palë të kërkuar ose kërkesues.

2. Nëse refuzimi për të dëshmuar bazohet në legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë kërkesues, Shteti Palë i kërkuar konsultohet me Shtetin Palë kërkesues.

3. Dëshmitari ose eksperti që përdor të drejtën për të refuzuar të dëshmojë, të parashikuar në paragrafin 1, nuk mund të dënohet për këtë arsye në Shtetin Palë kërkesues ose të kërkuar.

4. Pa cenuar ndonjë masë të miratuar për mbrojtjen e personave, Shteti Palë kërkesues, në përfundim të seancës dëgjimore, harton procesverbalin që tregon datën dhe vendin e seancës, identitetin e personit të dëgjuar, identitetet dhe funksionet e çdo personi tjetër në Shtetin Palë të kërkuar pjesëmarrës në seancë,

çdo betim të bërë dhe kushtet teknike në të cilat është zhvilluar seanca. Shteti Palë i kërkuar i dërgon dokumentin Shtetit Palë kërkuar.

5. Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme të sigurohet që, nëse dëshmitarët ose ekspertët dëgjojnë brenda territorit të tij, në përputhje me këtë nen dhe refuzojnë të dëshmojnë kur janë nën detyrimin për të dëshmuar ose për të mos dëshmuar të vërtetën, legjislacioni i tij i brendshëm të zbatohet njësoj sikur seanca dëgjimore të kishte ndodhur në një proces kombëtar.

Neni 34

Seanca dëgjimore me video konferencë

1. Nëse një person ndodhet në territorin e një Shteti Palë dhe duhet të dëgjohet si dëshmitar ose ekspert nga autoritetet gjyqësore të një Shteti tjetër Palë, ky i fundit mund të kërkojë që seanca gjyqësore të zhvillohet me video konferencë, siç e parashikon paragrafi 2 deri në 7. Ky paragraf mund të zbatohet edhe për përdorimin e video-konferencës për qëllime të tjera, siç janë identifikimi i objekteve, personave ose vendeve, nëse është rënë dakord nga Shteti Palë i kërkuar.

2. Shteti Palë i kërkuar bie dakord për seancën me video konferencë nëse përdorimi i video konferencës nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të tij dhe me kushtin që të ekzistojnë mjetet teknike për të zhvilluar seancën me video konferencë. Nëse Shteti Palë i kërkuar nuk ka mjetet teknike për të zhvilluar seancën me video konferencë, këto mjete mund të vihen në dispozicion të tij nga Shteti Palë kërkuar me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kërkesat për seancë me video konferencë, përveç informacionit të përmendur në nenin 25, përmbajnë emrin e autoritetit gjyqësor që zhvillon seancën ose, nëse është rënë dakord nga Shteti Palë i kërkuar, të një autoriteti tjetër kompetent që zhvillon seancën gjyqësore.

4. Autoriteti gjyqësor i Shtetit Palë të kërkuar mund të thërrasë personin e përfshirë të paraqitet në përputhje me format e përcaktuara në legjislacionin e tij të brendshëm.

5. Në lidhje me seancën dëgjimore me video konferencë, zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) Autoriteti gjyqësor i Shtetit Palë të kërkuar është i pranishëm gjatë seancës, kur është e nevojshme i ndihmuar nga një përkthyes, dhe mund të jetë përgjegjës për të siguruar edhe identifikimin e personit që do të dëgjohet edhe respektimin e parimeve themelore të legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar; nëse autoriteti gjyqësor i Shtetit Palë të kërkuar është i mendimit që gjatë seancës janë duke u shkelur parimet themelore të legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar, ai merr menjëherë masat e nevojshme për t'u siguruar që seanca të vazhdojë në përputhje me parimet në fjalë;

b) Masat për mbrojtjen e personit që do të dëgjohet miratohen, sipas nevojës, ndërmjet autoritetit kompetent të Palës kërkuar dhe të kërkuar;

c) Seanca dëgjimore zhvillohet direkt nga, ose nën drejtimin e, autoritetit gjyqësor të Shtetit Palë kërkuar në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm;

d) Me kërkesë të Shtetit Palë kërkuar ose personit që do të dëgjohet, Shteti Palë i kërkuar sigurohet që personi që do të dëgjohet të ndihmohet nga një përkthyes dhe/ose avokat, nëse është e nevojshme;

e) Personi që do të dëgjohet mund të pretendojë të drejtën për të mos dëshmuar e drejtë kjo që ai person do të përfitonte sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar ose kërkuar.

6. Shtetet Palë, me diskrecionin e tyre, gjithashtu mund të zbatojnë dispozitat e këtij neni për seancat me video konferencë që përfshijnë personin e akuzuar ose të dyshuar bazuar në pëlqimin e personit. Në këtë rast, vendimi për të zhvilluar video konferencë, dhe mënyra se si do të zhvillohet video konferenca, është objekt i pëlqimit të të dy Shteteve Palë të përfshira, dhe në përputhje me të drejtën e tyre të brendshme dhe instrumentet ndërkombëtare përkatëse.

7. Ky nen nuk cenon ndonjë marrëveshje apo rregullim që lejon që seanca dëgjimore me video konferencë të zhvillohet me mjete të tjera.

Neni 35

Paraqitja e personave në Shtetin Palë kërkuar

1. Nëse Shteti Palë kërkuar e konsideron të nevojshme paraqitjen personalisht të një dëshmitari ose eksperti përpara autoriteteve të tij gjyqësore, ai e shpreh këtë në kërkesën e tij për njoftimin për t'u

paraqitur. Shteti Palë i kërkuar fton dëshmitarin ose ekspertin të paraqitet në territorin e Shtetit Palë kërkuar dhe njofton, pa vonesë, Shtetin Palë kërkuar për përgjigjen e dëshmitarit ose ekspertit, nëse ka.

2. Në rastin e parashikuar në paragrafin 1, kërkesa ose fletëthirrja tregon shpërblimin e përafërt të pagueshëm dhe shpenzimet e rimbursueshme për udhëtim dhe ushqim.

3. Nëse bëhet një kërkesë specifike, Shteti Palë i kërkuar mund t'i japë paradhënie dëshmitarit ose ekspertit. Paradhënia rimbursohet nga Shteti Palë kërkuar.

4. Dëshmitari ose eksperti që nuk i përgjigjet fletëthirrjes për paraqitje, për të cilën është kërkuar njoftimi, edhe nëse kjo fletëthirrje përmban detyrime, nuk do t'i nënshtrohet ndonjë ndëshkimi apo mase shtrënguese, përveçse kur dëshmitari ose eksperti, më vonë, hyn vullnetarisht në territorin e Shtetit Palë kërkuar dhe thirret atje përsëri rregullisht.

Neni 36

Transferimi i përkohshëm i të ndaluarve

1. Një person i cili mbahet i ndaluar apo vuan dënimin në territorin e një Shteti Palë, dhe të cilit i kërkohet të jetë i pranishëm në një Shtet tjetër Palë për qëllim të identifikimit, dëshmisë ose dhënie ndihme për marrjen e provave për hetim, ndjekje penale apo proces gjyqësor në lidhje me krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë mund të transferohen nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) personi jep lirisht pëlqimin e tij pasi është informuar;

b) autoritetet kompetente të të dy Shteteve Palë bien dakord në bazë të kushteve që këto Shtete Palë mund t'i konsiderojnë të përshtatshme.

2. Për qëllime të paragrafit 1:

a) Shteti Palë ku është transferuar personi ka autoritetin dhe detyrimin për ta mbajtur personin e transferuar të ndaluar, nëse nuk kërkohet apo autorizohet ndryshe nga Shteti Palë prej të cilit personi është transferuar;

b) Shteti Palë ku është transferuar personi përmbush pa vonesë detyrimin e tij për ta kthyer personin në mbikëqyrjen e Shtetit Palë nga i cili është transferuar, siç është renë dakord përpara, apo siç është renë dakord ndryshe nga autoritetet kompetente të të dy Shteteve Palë;

c) Shteti Palë ku është transferuar personi nuk i kërkon Shtetit Palë nga i cili është transferuar personi që të fillojë procedura ekstradimi për kthimin e personit; personit të transferuar do t'i llogaritet kryerja e dënimit që është duke vuajtur në Shtetin Palë nga ku është transferuar për kohën e vuajtur në burg në Shtetin Palë në të cilin është transferuar.

Neni 37

Imuniteti

1. Një dëshmitar, ekspert ose person tjetër që, me kërkesë të Shtetit Palë kërkuar, pranon të japë prova në një proces ose të ndihmojë në një hetim, ndjekje penale ose proces gjyqësor në territorin e Shtetit Palë kërkuar, nuk do të ndiqet penalisht, ndalohet, ndëshkohet ose nuk do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij personale në atë territor në lidhje me veprime, mosveprime ose dënime përpara largimit të tij nga territori i Shtetit Palë të kërkuar.

2. Imuniteti i parashikuar në paragrafin 1 mbaron kur dëshmitari, eksperti ose një personi tjetër:

a) gjithsesi ka qëndruar me dëshirë në territorin e Shtetit Palë kërkuar edhe pse ka pasur mundësinë të largohet për një periudhë prej pesëmbëdhjetë ditësh të njëpasnjëshme, ose për çdo periudhë të dakordësuar nga Shtetet Palë nga data e njoftimit zyrtar të personit që autoritetet gjyqësore nuk kërkojnë më që të jetë i pranishëm;

b) është kthyer me vullnetin e tij të lirë pasi është larguar nga territori i Shtetit Palë kërkuar.

Neni 38

Përcjellja e objekteve, dokumenteve, të dhënave ose provave të tjera

1. Me kërkesë, Shteti Palë i kërkuar mund të përcjellë objektet, dokumentet, të dhënat ose provat e kërkuar në Shtetin Palë kërkuar. Nëse Shteti Palë kërkuar kërkon shprehimisht përcjelljen e kopjeve

originale të dokumenteve, të dhënave ose provave të tjera, Shteti Palë i kërkuar do të bëjë çdo përpjekje për të plotësuar kërkesën.

2. Shtetit Palë kërkuar kthen atë që i është përcjellë sa më shpejt që të jetë e mundur ose të paktën pas përfundimit të procesit, përveçse kur Shteti Palë i kërkuar heq dorë shprehimisht nga kthimi.

Neni 39

Teknika të posaçme hetimore

1. Çdo Shtet Palë, nëse e lejonë parimet bazë të sistemit ligjor të brendshëm, brenda mundësive të tij dhe sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i tij i brendshëm, merr masat e nevojshme për të lejuar brenda territorit të tij përdorimin e duhur nga autoritetet e tij kompetente të dorëzimit të kontrolluar dhe kur e gjykon të përshtatshme, të teknikave të posaçme hetimore si përgjimet elektronike apo forma të tjera të vëzhgimeve dhe operacionet të fshehta me qëllim hetimin dhe ndjekjen penale të efektshme të krimeve për të cilat zbatohet kjo Konventë.

2. Për qëllime të hetimit të krimeve për të cilat Shtetet Palë zbatojnë këtë Konventë, ato inkurajohen që kur është e nevojshme të nënshkruajnë marrëveshje të përshtatshme dypalëshe apo shumëpalëshe apo rregullime për përdorimin e teknikave të posaçme hetimore në kontekstin e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar. Këto marrëveshje ose rregullime lidhen në përputhje të plotë me parimin e barazisë sovrane të Shteteve dhe realizohen rreptësisht në përputhje me termat e këtyre marrëveshjeve apo rregullimeve.

3. Në mungesë të një marrëveshjeje apo rregullimi të përmendur në paragrafin 2, vendimet për të përdorur teknika të posaçme hetimore në nivel ndërkombëtar merren rast pas rasti dhe, kur është e nevojshme, mund të marrin në konsideratë marrëveshjet dhe memorandumet financiare në lidhje me ushtrimin e juridiksionit nga Shtetet Palë në fjalë.

Neni 40

Hetime në mbulim/të fshehta

1. Shteti Palë kërkuar dhe i kërkuar mund të bien dakord të ndihmojnë njëri-tjetrin për kryerjen e hetimeve të krimeve për të cilat Shtetet Palë në fjalë zbatojnë këtë Konventë nga oficerët që veprojnë në mbulim ose me identitet të rreme (hetime të fshehta).

2. Vendimi për kërkesën merret në çdo rast të veçantë nga autoritetet kompetente të Shtetit Palë të kërkuar duke pasur parasysh legjislacionin e brendshëm dhe procedurat. Kohëzgjatja e hetimit të fshehtë, kushtet e detajuara dhe statusi ligjor i oficerëve në fjalë gjatë hetimeve në mbulim dakordësohet mes autoriteteve kompetente të Shtetit kërkuar dhe të kërkuar duke pasur parasysh legjislacionin e tyre të brendshëm dhe procedurën.

3. Hetimet e fshehta zhvillohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe procedurat e Shtetit Palë në territorin e të cilit zhvillohet hetimi i fshehtë. Autoritetet kompetente të Shteteve Palë të përfshira, bashkëpunojnë për të siguruar që hetimi i fshehtë të jetë i përgatitur dhe i mbikëqyrur dhe për të marrë masa për sigurinë e oficerëve që veprojnë nën fshehtësi ose me identitet të rreme.

4. Çdo Shtet Palë, për qëllime të paragrafit 2, do të tregojë autoritetet kompetente duke informuar autoritetet qendrore të Shteteve Palë, ose, nëse plotësohen kushtet në nenin 85, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, Shtetin e caktuar për të dhënë mbështetje të përkohshme shtesë.

Neni 41

Ekipet e përbashkëta hetimore

1. Me marrëveshje të ndërsjellë, autoritetet kompetente të dy ose më shumë Shteteve Palë mund të marrin masat e nevojshme, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe ndërkombëtar, që të krijojnë një ekip të përbashkët hetimor për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë kohore të caktuar, që mund të zgjatet me miratimin e ndërsjellë të të dyja palëve, për të zhvilluar hetime në një ose më shumë Shtete Palë të përfshira.

2. Përbërja e ekipit do të vendoset në marrëveshje. Ekipi i përbashkët hetimor në veçanti mund të krijohet nëse:

a) hetimet e një Shteti Palë për krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë kërkojnë hetime të vështira dhe sfiduese që kanë lidhje me Shtete të tjera Palë;

b) disa Shtete Palë hetojnë krime për të cilat zbatohet kjo Konventë kur rrethanat e çështjes kërkojnë veprim të koordinuar, të bashkërenduar në Shtetet Palë të përfshira.

3. Kërkesa për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor mund të bëhet nga çdo Shtet Palë i përfshirë. Ekipi krijohet në një nga Shtetet Anëtare ku pritet që të kryhen hetimet.

4. Përveç informacionit të përmendur në dispozitat përkatëse të nenit 24, kërkesat për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor përfshijnë propozime për përbërjen e ekipit, qëllimin dhe kohëzgjatjen për të cilin do të krijohet ekipi i përbashkët hetimor.

5. Ekipi i përbashkët hetimor vepron në territorin e Shteteve Anëtare që krijojnë ekipin sipas kushteve të përgjithshme të mëposhtme:

a) drejtuesi ose drejtuesit e ekipit përfaqëson/jnë autoritetet kompetente pjesëmarrëse në hetime penale të Shtetit Palë ku operon ekipi;

b) drejtuesi/t i/e ekipit vepron/jnë brenda caqeve të kompetencave të tyre sipas legjislacionit të brendshëm përkatës;

c) ekipi kryen operacionet e tij në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë ku operon ekipi;

d) anëtarët dhe anëtarët e komanduar të ekipit kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin e personave të përmendur në nënparagrafin “a”, duke marrë parasysh kushtet e vendosura nga autoritetet e tyre në marrëveshjen për krijimin e ekipit;

e) Shteti Palë ku vepron ekipi bën rregullimet e duhura organizative që ekipi të kryejë operacionet e tij.

6. Në këtë nen, anëtarët e ekipit të përbashkët hetimor të Shtetit Palë ku operon ekipi quhen “anëtarë” ndërsa anëtarët e Shteteve Palë të ndryshëm nga Shteti Palë ku operon ekipi quhen “anëtarë të komanduar”.

7. Anëtarët e komanduar të ekipit të përbashkët hetimor kanë të drejtë të jenë të pranishëm kur merren masat hetimore në Shtetin Palë ku operon ekipi. Megjithatë, drejtuesi i ekipit mund të vendosë ndryshe për arsye të veçanta, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë ku operon ekipi.

8. Anëtarët e komanduar të ekipit të përbashkët hetimor, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë ku operon ekipi, mund të ngarkohen nga drejtuesi i ekipit me detyrën e marrjes së disa masave hetimore kur kjo është e miratuar nga autoritetet kompetente të Shtetit Palë ku operon ekipi dhe të Shtetit Palë komandues.

9. Kur ekipi i përbashkët hetimor ka nevojë që të merren masa hetimore në një nga Shtetet Anëtare që krijojnë ekipin, anëtarët e komanduar në ekip të atij Shteti Palë mund të kërkojnë që autoritetet kompetente të tij të marrin këto masa. Këto masa konsiderohen në atë Shtet Palë sipas kushteve që do të zbatoheshin nëse do të kërkoreshin në një hetim kombëtar.

10. Nëse ekipi i përbashkët hetimor ka nevojë për ndihmë nga një Shtet Palë i ndryshëm nga ato që kanë krijuar ekipin, ose nga një Shtet i tretë, kërkesa për ndihmë mund të bëhet nga autoritetet kompetente të Shtetit Palë ku operon ekipi drejtuar autoriteteve kompetente të Shtetit tjetër në fjalë në përputhje me instrumentet ose rregullimet përkatëse.

11. Anëtarët e komanduar të ekipit të përbashkët hetimor, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe brenda caqeve të kompetencës së tyre, mund t’i japin ekipit informacion në dispozicion në Shtetin Palë që i ka komanduar për qëllim të hetimit penal të kryer nga ekipi.

12. Informacioni i marrë në mënyrë të ligjshme nga një anëtar ose anëtar i komanduar ndërkohë që ka qenë pjesë e një ekipi të përbashkët hetimor i cili përndryshe nuk është në dispozicion të autoriteteve kompetente të Shteteve Palë në fjalë mund të përdoret për qëllimet e mëposhtme:

a) për qëllimet për të cilat është krijuar ekipi;

b) për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të tjera, me pëlqimin paraprak të autoritetit kompetent të Shtetit Palë ku është vënë në dispozicion informacioni, i cili mund të mos jepet vetëm kur ky përdorim do të rrezikonte hetimet penale në atë Shtet Palë ose në lidhje me të cilin ky Shtet Palë mund të refuzojë ndihmën e ndërsjellë juridike;

c) për parandalimin e një kërcënimi të afërt dhe të rëndë ndaj sigurisë publike, dhe pa cenuar nënparagrafin “b” nëse rrjedhimisht fillon një hetim penal;

d) për qëllime të tjera në masën e dakordësuar ndërmjet Shteteve Palë që kanë krijuar ekipin.

13. Ky nen nuk cenon ndonjë nga dispozitat ose rregullimet ekzistuese për krijimin ose funksionimin e ekipeve të përbashkëta hetimore.

14. Në masën që e lejon legjislacionet e Shteteve Palë të përfshira ose dispozitat e ndonjë instrumenti ligjor të zbatueshëm mes tyre, mund të dakordësohet që persona të ndryshëm nga përfaqësuesit e autoriteteve kompetente të Shteteve Palë që kanë krijuar ekipin e përbashkët hetimor të marrin pjesë në aktivitetet e ekipit. Të drejtat që u jepen anëtarëve ose anëtarëve të komanduar të ekipit sipas këtij neni nuk zbatohen për këta persona nëse nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe në marrëveshje.

Neni 42

Vëzhgime ndërkuftare

1. Punonjësit e Policisë të njërit prej Shteteve Palë që, brenda kuadrit të një hetimi penal, mbajnë nën vëzhgim në vendin e tyre një person që supozohet se ka marrë pjesë në një krim për të cilin zbatohet kjo Konventë, ose një person që besohet fuqimisht se do të çojë në identifikimin ose vendndodhjen e personit të lartpërmendur, mund të autorizohen që të vazhdojnë vëzhgimet e tyre në territorin e një Shteti tjetër Palë nëse ky i fundit ka autorizuar vëzhgimin ndërkuftar në përgjigje të një kërkesë për ndihmë që i është paraqitur më përpara. Kushtet mund t'i bashkëlidhen autorizimit.

2. Me kërkesë, vëzhgimi ndërkuftar mund t'i besohet oficerëve të Shtetit Palë në territorin e të cili po kryhet vëzhgimi.

3. Kërkesa për ndihmë e përmendur në paragrafin 1 i dërgohet një autoriteti të caktuar nga çdo Shtet Palë dhe kompetent për të dhënë ose përcjellë autorizimin e kërkuar.

4. Vëzhgimi ndërkuftar, nëse kryhet nga një ose më shumë oficerë të përmendur në paragrafin 1, kryhet vetëm sipas kushteve të përgjithshme të mëposhtme:

a) oficerët e vëzhgimit duhet të respektojnë dispozitat e këtij neni dhe legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë në territorin e të cilit ata po veprojnë; ata duhet të zbatojnë udhëzimet e autoriteteve kompetente të atij Shteti Palë;

b) gjatë vëzhgimit, oficerët mbajnë një dokument që provon se autorizimi është dhënë;

c) oficerët e vëzhgimit në çdo moment duhet të provojnë që ata po veprojnë në cilësinë zyrtare;

d) oficerët e vëzhgimit mund të mbajnë armë shërbimi gjatë vëzhgimit, përveçse kur vendoset ndryshe në mënyrë specifike nga Shteti Palë i kërkuar; përdorimi i tyre do të ndalohet përveçse në raste të vetëmbrojtjes së ligjshme në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar;

e) Ndalohet hyrja në shtëpi dhe vende private të paaksesueshme nga publiku;

f) Oficerët e vëzhgimit nuk mund as të ndalojnë dhe pyesin, as të arrestojnë personin nën vëzhgim.

g) Të gjitha operacionet janë objekt i një raporti për autoritetet e Shtetit Palë në territorin e të cilit kanë ndodhur; oficerëve të vëzhgimit mund t'ju kërkohej që të paraqiten personalisht;

h) Autoritetet e Shtetit Palë nga vijnë oficerët e vëzhgimit, me kërkesë të autoriteteve të Shtetit Palë në territorin e të cili ka ndodhur vëzhgimi, do të ndihmojnë hetimin në vijim të operacionit ku kanë marrë pjesë, përfshirë çdo proces ligjor.

Neni 43

Përgjegjësia penale e nëpunësve

Gjatë veprimeve të përmendura në nenet 39, 40, 41 ose 42, përveç rasteve kur vetë Palët kanë rënë dakord ndryshe, nëpunësit e një Shteti Palë, të ndryshëm nga Shteti Palë ku zhvillohet operacioni, konsiderohen nëpunës të Shtetit Palë të fundit në lidhje me krimet e kryera kundër tyre ose nga ata vetë.

Përgjegjësia civile e nëpunësve

1. Nëse, në përputhje me nenet 39, 40, 41 ose 42, nëpunësit e një Shteti Pale veprojnë në një Shtet tjetër Palë, Shteti Palë i parë është përgjegjës për çdo dëm që u shkaktohet atyre gjatë operacioneve, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë, ku zhvillohet operacioni.

2. Shteti Palë, ku u shkaktua dëmi i përmendur paragrafin 1 jep dëmshpërblim për këtë dëm sipas kushteve të zbatueshme për çdo dëm të shkaktuar nga nëpunësit e tij.

3. Shteti Palë nëpunësit e të cilit i kanë shkaktuar dëm një personi në territorin e një Shteti tjetër Palë do të rimbursojë plotësisht Shtetin Palë të fundit për çdo kompensim që i është dhënë një personi.

4. Pa cenuar ushtrimin e të drejtave të tyre *vis-à-vis* palëve të treta dhe me përjashtim të paragrafit 3, çdo Shtet Palë, në rastin e parashikuar në paragrafin 1, heq dorë nga kërkimi i rimbursimit të dëmit të pretenduar nga Shteti tjetër Palë.

5. Dispozitat e këtij neni zbatohen nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga Shtetet Palë të përfshira.

Bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllime të konfiskimit

1. Një Shtet Palë që ka marrë një kërkesë për konfiskimin e të ardhurave të krimit ose pronës vlere të cilës i korrespondon vlerës së këtyre të ardhurave të krimit për të cilin zbatohet kjo Konventë, përfshirë pasurinë e pastruar, ose pasurinë, pajisjet ose mjetet e tjera të përdorura ose të destinuara për përdorim për këto krime, ose pronë tjetër që ndodhet në territorin e tij me qëllim që të dëmshpërblejë viktimat në përputhje me nenin 83, paragrafi 3, në masën më të madhe të mundshme dhe në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm:

a) ose i dërgon kërkesën autoriteteve të tij kompetente me qëllim për të siguruar një urdhër konfiskimi dhe, nëse jepet ky urdhër, e ekzekuton atë; ose

b) ose i dërgon autoriteteve kompetente për zbatim në masën e kërkuar një urdhër konfiskimi të dhënë nga një gjykatë në territorin e Shtetit Palë kërkues, sa kohë që lidhet me të ardhurat e krimit, pronën, pajisje ose mjete të tjera që ndodhen në territorin e Shtetit Palë të kërkuar të cilat janë përdorur ose janë destinuar për t'u përdorur për krime për të cilat zbatohet kjo Konventë.

2. Pas një kërkesë të bërë nga një Shtet tjetër Palë që ka juridiksion mbi një krim për të cilin zbatohet kjo Konventë, Shteti Palë i kërkuar, në masën më të madhe të mundshme në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, merr masa për të identifikuar, gjurmuar dhe ngrirë ose sekuestruar të ardhurat e krimit, pronën, pajisje ose mjete të tjera të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur për krime për të cilat zbatohet kjo Konventë, me qëllim që të urdhërohet konfiskimi i mundshëm ose nga Shteti Palë kërkues, ose, sipas një kërkesë të bërë sipas paragrafit 1, nga Shteti Palë i kërkuar.

3. Nëse të ardhurat e krimit janë transformuar ose konvertuar, pjesërisht ose plotësisht në pronë tjetër, kjo pronë do t'i nënshtrohet masave të përmendura në këtë nen në vend të të ardhurave të krimit.

4. Nëse të ardhurat e kthimit janë përzierë me pronën e fituar nga burime të ligjshme, kjo pronë, pa cenuar kompetencat që lidhen me ngrirjen ose sekuestrimin, është objekt konfiskimi deri në vlerën e llogaritur të të ardhurave të përziera të krimit.

5. Të ardhurat ose përfitime të tjera që rrjedhin nga të ardhurat e krimit, nga prona ku janë transformuar ose konvertuar të ardhurat e krimit, ose nga prona me të cilën të ardhurat e krimit janë përzierë janë gjithashtu objekt i masave të përmendura në këtë nen, në të njëjtën mënyrë dhe masë si të ardhurat e krimit.

6. Për qëllimet e këtij neni, çdo Shtet Palë autorizon gjykatat e tij ose autoritete të tjera kompetente që të urdhërojnë vënien në dispozicion ose ngrirjen e të dhënave bankare, financiare ose tregtare. Shtetet Palë nuk do të refuzojnë të veprojnë sipas dispozitave të këtij paragrafi për shkak të sekretit bankar.

7. Dispozitat e paragrafit 1 mund të zbatohen edhe për konfiskimin që ka të bëjë me një kërkesë për të paguar një shumë parash që korrespondon me vlerën e të ardhurave të krimit, nëse prona për të cilën duhet të ekzekutohet konfiskimi ndodhet në Shtetin Palë të kërkuar. Në këto raste, gjatë ekzekutimit të konfiskimit sipas paragrafit 1, Shteti Palë i kërkuar, nëse nuk është marrë pagesa, mund të vërë në lëvizje pretendimin për çdo pronë në dispozicion për atë qëllim.

8. Shtetet Palë, në masën që e lejon legjislacioni i tyre i brendshëm, mund të bashkëpunojnë me ato Shtete Palë që kërkojnë ekzekutimin e masave ekuivalente me konfiskimin që çon në heqjen e pronës, të cilat nuk janë dënime penale, sa kohë që këto masa urdhërohen nga një autoritet gjyqësor i Shtetit Palë kërkuar në lidhje me krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë, me kusht që të jetë vendosur se prona përbën të ardhura të krimit, ose pronë tjetër të përmendur në paragrafët 3 deri në 5.

9. Përveç informacionit të specifikuar në nenin 25, kërkesat e bëra në përputhje me këtë nen përmbajnë:

a) në rastin e një kërkesë që ka lidhje me paragrafin 1, nënparagrafi “a”, përshkrimin e pronës ose pasurive që do të konfiskohen dhe deklarin e fakteve mbi të cilat mbështetet Shteti Palë kërkuar të mjaftueshme për të bërë që Shteti Palë i kërkuar të kërkojë urdhrin sipas legjislacionit të tij të brendshëm;

b) në rastin e një kërkesë që ka lidhje me paragrafin 1, nënparagrafi “b”, një kopje të pranueshme ligjërisht të një urdhri konfiskimi mbi të cilin bazohet kërkesa e nxjerrë nga Shteti Palë kërkuar, një deklarin të fakteve dhe informacionin për masën në të cilën kërkohet ekzekutimi i urdhrit;

c) në rastin e një kërkesë që ka lidhje me paragrafin 2, një deklarin të fakteve mbi të cilat mbështetet Shteti Palë dhe një përshkrim të veprimeve të kërkuara.

10. Vendimet ose veprimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 merren nga Shteti Palë i kërkuar në përputhje me dhe sipas dispozitave të legjislacionit të tij të brendshëm dhe rregullave procedurale ose çdo konvente, marrëveshjeje ose rregullimi ekzistues dypalësh ose shumëpalësh me Shtetin Palë kërkuar.

11. Dispozitat e këtij neni nuk interpretohen se cenojnë të drejtat e palës së tretë që vepron në mirëbesim.

Neni 46

Kthimi

1. Me kërkesë të Shtetit Palë kërkuar dhe pa cenuar të drejtat e palëve të treta që veprojnë në mirëbesim, Shteti Palë i kërkuar, në masën që e lejon legjislacioni i tij i brendshëm, mund të vendosë në dispozicion të Shtetit Palë kërkuar pronën e sekuestruar ose të konfiskuar të siguruar nga një krim për të cilin Shtetet Palë në fjalë e zbatojnë këtë Konventë. Shteti Palë kërkuar mund të vendosë t’i kthejë pronën pronarëve të saj të ligjshëm.

2. Gjatë përcjelljes së objekteve, dokumenteve, të dhënave ose provave, Shteti Palë i kërkuar mund të tërhiqet nga kthimi i tyre, ose përpara ose pas përcjelljes në Shtetin Palë kërkuar, nëse në këtë mënyrë mund të lehtësohet kthimi i këtyre objekteve, dokumenteve, të dhënave ose provave te pronari i tyre i ligjshëm.

Neni 47

Asgjësimi i pasurive të konfiskuara, përfshirë kthimin ose ndarjen

1. Të ardhurat e krimit ose prona e konfiskuar nga një Shtet Palë sipas nenit 45 asgjësohen nga ai Shtet Palë në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe procedurat administrative.

2. Shtetet Palë, kur veprojnë në lidhje me një kërkesë të bërë nga një Shtet tjetër Palë në përputhje me nenin 45, në masën që e lejon legjislacioni i brendshëm dhe nëse kërkohet, i japin përparësi rëndësishme për t’i kthyer Shtetit Palë kërkuar të ardhurat e krimit ose pronën ose vlerën që i korrespondon këtyre të ardhurave ose prone të konfiskuar në mënyrë që ai të dëmshpërblejë viktimat e krimeve për të cilat Shtetet Palë zbatojnë këtë Konventë ose që ai të kthejë këto të ardhura të krimit ose këtë pronë te pronarët e saj të ligjshëm.

3. Një Shtet Palë, kur vepron në lidhje me një kërkesë të bërë nga një Shtet tjetër Palë në përputhje me nenin 45, mund t’i japë rëndësi të veçantë lidhjes së marrëveshjeve ose rregullimeve me Shtete të tjera Palë, rregullisht ose rast pas rasti, për ndarjen e këtyre të ardhurave të krimit ose prone, ose fondeve që rrjedhin nga shitja e këtyre të ardhurave të krimit ose prone, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm ose procedurat administrative.

Neni 48

Transferimi i procedimeve

Shtetet Palë mund të konsiderojnë mundësinë e transferimit të procedimeve në një tjetër për ndjekjen penale të një krimi për të cilin ato zbatojnë këtë Konventë në rastet kur ky transferim konsiderohet se është në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, sidomos në çështjet ku përfshihen disa juridiksione.

PJESA IV EKSTRADIMI

Neni 49

Objekti i pjesës IV

1. Dispozitat e kësaj Pjese zbatohen për krimet për të cilat zbatohet kjo Konventë kur personi që është subjekt i kërkesës së një Shteti Palë për ekstradim ndodhet në territorin e Shtetit Palë të kërkuar.

2. Pa cenuar nenin 51, ekstradimi pranohet nëse krimi është i dënueshëm me heqje lirie për periudhë maksimale të paktën një vit sipas legjislacionit të brendshëm edhe të Shtetit Palë të kërkuar edhe të Shtetit Palë kërkuar. Kur një person dënohet me burg në Shtetin Palë kërkuar, kohëzgjatja e dënimit të mbetur për t'u vuajtur do të jetë për një periudhë të paktën gjashtë muaj.

3. Nëse kërkesa për ekstradim përfshin disa krime të veçanta, të paktën një prej të cilëve është i ekstradueshëm sipas kësaj Konvente dhe disa prej të cilave nuk mbulohen nga kjo Konventë, Shteti Palë i kërkuar mund të zbatojë dispozitat e këtij neni edhe në lidhje me krimet më të fundit.

4. Secili prej krimeve për të cilin Shtetet Palë zbatojnë këtë Konventë do të konsiderohet i përfshirë si një krim i ekstradueshëm në çdo marrëveshje ekstradimi të zbatueshme mes tyre. Shtetet Palë marrin përsipër të përfshijnë këto krime si krime të ekstradueshme në çdo marrëveshje ekstradimi të lidhur mes tyre.

Neni 50

Baza ligjore për ekstradimin

Nëse një Shtet Palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një traktati merr një kërkesë për ekstradim nga një tjetër Shtet Palë me të cilin nuk ka marrëveshje ekstradimi, ai duhet të konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me çdo krim për të cilin zbatohet kjo Konventë.

Neni 51

Shkaqet e refuzimit

1. Ekstradimi refuzohet, nëse:

a) Shteti Palë i kërkuar ka shkaqe thelbësore për të besuar që kërkesa është bërë për qëllim të ndjekjes penale ose dënimit të një personi për shkak të racës, seksit, orientimit seksual, fesë, kombësisë, origjinës etnike, opinioneve politike ose përkatësisë në një grup të caktuar social, ose që përmbushja e kërkesës do të cenonte pozitën e atij personi për ndonjë prej këtyre shkaqeve;

b) kërkesa ka të bëjë me një krim të dënueshëm me dënim me vdekje sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë kërkuar, përveçse kur, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar;

i. Shteti Palë kërkuar jep garanci të besueshme, të mjaftueshme dhe të efektshme ose, nëse kërkohet nga Shteti Palë i kërkuar, bie dakord për një kusht, që plotëson kërkesat e Shtetit Palë të kërkuar, që dënimi me vdekje nuk do të vendoset; ose

ii. kur është e mundur sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar, nëse është dhënë tashmë dënimi me vdekje, Shteti Palë kërkuar jep garanci të besueshme, të mjaftueshme dhe të efektshme, ose, nëse kërkohet nga Shteti Palë i kërkuar, bie dakord për një kusht që plotëson kërkesat e Shtetit Palë të kërkuar, që dënimi me vdekje nuk do të ekzekutohet;

c) Shteti Palë i kërkuar ka marrë tashmë një vendim gjyqësor të formës së prerë kundër personit që kërkohet të ekstradohet, për një krim të bazuar në të njëjtën sjellje kriminale;

d) ka shkaqe thelbësore për të besuar se personi që kërkohet të ekstradohet do t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, një shkeljeje flagrante të së drejtës për gjykim të drejtë ose shkeljeve të tjera flagrante të të drejtave themelore të njeriut në Shtetin Palë kërkues në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar;

2. Ekstradimi mund të refuzohet, nëse:

a) personi i kërkuar do të përballlet me rrezikun real të dënimit me burgim të përjetshëm pa të drejtë lirim me kusht ose të dënimit pa afat të caktuar;

b) personi i kërkuar do të gjykohet përpara një gjykate ose tribunali kompetent ndërkombëtar, të njohur nga Shteti Palë i kërkuar;

c) personi i kërkuar është dënuar përfundimisht nga një gjykatë ose tribunal kompetent ndërkombëtar juridiksioni i të cilit njihet nga Shteti Palë i kërkuar ose nga një Shtet tjetër, për një krim të bazuar në të njëjtën sjellje kriminale;

d) autoritetet kompetente të Shtetit Palë të kërkuar ndjekin penalisht personin që kërkohet të ekstradohet në lidhje me një krim të dyshuar bazuar në të njëjtën sjellje kriminale për të cilën kërkohet ekstradimi;

e) kërkesa është bërë në emër të një gjykate ose tribunali të jashtëzakonshëm ose *ad hoc* të Shtetit Palë kërkues, përveçse kur autoritetet kompetente të Shtetit Palë kërkues japin garancitë e konsideruara të mjaftueshme që vendimi do të jepet nga një gjykatë e cila përgjithësisht ka kompetencë që të shprehet për çështje penale, sipas rregullave të administrimit gjyqësor;

f) Shteti Palë i kërkuar ka marrë kërkesa të njëkohshme nga më shumë se një Shtet ose gjykatë apo tribunal penal kompetent ndërkombëtar dhe ka miratuar një prej këtyre kërkesave;

g) kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente;

h) dorëzimi i personit të kërkuar ka gjasa të ketë pasoja jashtëzakonisht të rënda për atë person, sidomos për shkak të moshës ose gjendjes shëndetësore të personit;

i) pa cenuar nenin 11, krimi është parashkuar nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë të kërkuar, përveçse kur kjo do të ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare;

j) Shteti Palë i kërkuar konsideron që ekzekutimi i kërkesës ka gjasa të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera thelbësore;

3. Përpara refuzimit të një kërkesë sipas këtij neni, ose shtyrjes së ekzekutimit të saj sipas nenit 54 paragrafi 3, Shteti Palë i kërkuar konsultohet sipas rastit me Shtetin Palë kërkues për të marrë parasysh nëse ekstradimi mund të miratohet sipas termave dhe kushteve që i konsideron të nevojshme. Nëse Shteti Palë kërkues pranon ekstradimin sipas këtyre kushteve, ai i përmbush këto kushte.

Neni 52

Rregulli i specialitetit

1. Një person që është ekstraduar nuk do të ndiqet penalisht, nuk do të dënohet apo nuk do të ndalohet me qëllim ekzekutimin e një dënimi ose urdhri ndalimi për një krim të kryer përpara ekstradimit të tij të ndryshëm nga ai për të cilin ai është ekstraduar, dhe as nuk do t'i kufizohet liria personale për ndonjë arsye tjetër, përveçse në rastet e mëposhtme:

a) kur Shteti Palë që e ka ekstraduar jep pëlqimin e tij. Kërkesa për pëlqim dorëzohet e shoqëruar me dokumente të përmendura në nenin 56 dhe çdo informacion shtesë të kërkuar nga Shteti Palë që e ka ekstraduar personin e kërkuar. Heqja dorë nga specialiteti mund të pranohet për krimet që do të ishin objekt i ekstradimit në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, ose në përputhje me çdo marrëveshje tjetër të zbatueshme për të dyja Shtetet Palë, ose në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare ose legjislacionit të brendshëm, kur është e pranueshme nga Shteti Palë i kërkuar;

b) kur personi, pasi ka pasur mundësinë që të largohet nga territori i Shtetit Palë kërkues ku ai person është ekstraduar, nuk është larguar brenda 45 ditëve nga lirim i tij përfundimtar, ose kur personi është kthyer në atë territor pasi është larguar.

2. Pavarësisht paragrafit 1, Shteti Palë kërkues mund të marrë masat e nevojshme që të largojë personin nga territori i tij, ose çdo masë të nevojshme sipas legjislacionit të tij të brendshëm, përfshirë procedimin *në mungesë*, për të parandaluar ndonjë pasojë ligjore që rezulton nga parashkrimi.

3. Kur përshkrimi i krimit për të cilin është ngritur akuza ndryshon gjatë procedimit, personi i ekstraduar do të ndiqet penalisht ose do të dënohet vetëm për atë krim sipas përshkrimit të tij të ri me sjelljen kriminale të dyshuar të personit të ekstraduar përbën krim të ekstradueshëm.

Neni 53

Riekstradimi në një Shtet të tretë

Përveç asaj që parashikon neni 52, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, Shteti Palë kërkuar, pa pëlqimin e Shtetit Palë të kërkuar, nuk ekstradon në një Shtet tjetër Palë ose Shtet të tretë një person të ekstraduar në Shtetin Palë kërkuar dhe të kërkuar nga ai Shtet Palë ose Shteti i tretë në lidhje me krime të kryera përpara ekstradimit të tij. Shteti Palë i kërkuar mund të kërkojë prodhimin e dokumenteve të përmendura në nenin 56, paragrafi 2.

Neni 54

Ekstradimi i shtetasve

1. Ekstradimi mund të refuzohet për arsye shtetësie. Kur ekstradimi refuzohet për këtë arsye, zbatohet neni 14.

2. Sa herë që një Shtet Palë, sipas legjislacionit të tij të brendshëm, lejohet që të ekstradojë ose përndryshe të dorëzojë një nga shtetasit e tij vetëm me kushtin që ai person do t'i kthehet atij Shteti Palë që të vuajë dënimin e dhënë si pasojë e gjykimit ose proceseve për të cilat është kërkuar ekstradimi ose dorëzimi i personit të kërkuar dhe Shteti Palë që kërkon ekstradimin e personit e pranon këtë dhe kushtet e tjera që Shtetet Palë të përfshira mund të konsiderojnë të përshtatshme, ky ekstradim ose dorëzim i kushtëzuar do të mjaftojë për të përmbushur detyrimin që përmban neni 14.

3. Nëse ekstradimi i kërkuar për qëllim të ekzekutimit të një dënimi refuzohet sepse personi që kërkohet është shtetas i Shtetit Palë të kërkuar, Shteti Palë i kërkuar, nëse e lejon legjislacioni i tij i brendshëm, me kërkesë të Shtetit Palë kërkuar, ekzekuton dënimin e dhënë sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë kërkuar ose pjesën e mbetur të tij në përputhje me nenet 75 deri në 79.

Neni 55

Ekzekutimi i kërkesës

1. Ekzekutimi i kërkesës për ekstradim i nënshtrohet kushteve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë të kërkuar.

2. Nëse Shteti Palë i kërkuar refuzon të gjithë apo një pjesë të kërkesës për ekstradim, apo nëse shtyn ekzekutimin e kërkesës, arsyet e refuzimit ose shtyrjes i bëhen me dije Shtetit Palë kërkuar, sipas rrethanave.

Neni 56

Kërkesa dhe dokumentet mbështetëse

1. Kërkesa për ekstradim bëhet me shkrim sipas kushteve që e lejojnë Shtetin Palë të kërkuar që të vërtetojë autenticitetin.

2. Kërkesa për ekstradim duhet të përmbajë ose të shoqërohet me sa më poshtë:

a) një përshkrim të personit të kërkuar, së bashku me çdo informacion tjetër që mund të ndihmojë për të përcaktuar identitetin, shtetësinë dhe vendndodhjen e atij personi;

b) tekstin e dispozitave përkatëse të ligjit që parashikojnë krimin apo kur është e nevojshme parashikimin në ligj në lidhje me krimin dhe dënimin që mund të vendoset për krimin;

c) nëse personi është akuzuar për një krim, një urdhër të lëshuar nga një gjykatë apo një autoritetet tjetër gjyqësor kompetent për arrestimin e atij personi apo një kopje të njësuar të atij urdhri, përcaktimin e krimit për të cilin kërkohet ekstradimi dhe një përshkrim të veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë krimin e dyshuar, përfshirë kohën dhe vendin e kryerjes së tij;

d) nëse personi është dënuar për një krim, përcaktimin e krimit për të cilin kërkohet ekstradimi dhe një përshkrim të veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë krimin, duke përfshirë kohën dhe vendin e kryerjes së tij, dhe vendimin gjyqësor ose çdo dokument tjetër që përcakton dënimin dhe dënimin e dhënë, faktin që dënimi është i ekzekutueshëm, dhe kohëzgjatjen e pjesës së dënimit që mbetet për t'u vuajtur.

e) nëse personi është dënuar për një krim në mungesë të tij, përveç dokumenteve të përcaktuara në nënparagrafin "d", një përcaktim të çdo kërkesë procedurale, garancive ose mjeteve të tjera ligjore për mbrojtjen e atij personi, sidomos të drejtën për rigjykim ose ankimim në prani të atij personi.

f) nëse personi është dënuar për një krim, por nuk është dhënë masa e dënimit, përcaktimi i krimit për të cilin kërkohet ekstradimi dhe një përshkrim i veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë krimin, një dokument që përcakton dënimin dhe një deklaratë që shpreh synimin për të vendosur një masë dënimi.

g) çdo informacion dhe/ose provë tjetër, të parashikuar në legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar.

3. Nëse Shteti Palë i kërkuar konsideron që informacioni i dhënë në mbështetje të një kërkesë për ekstradim nuk është i mjaftueshëm për të marrë një vendim, ai mund të kërkojë që të jepet informacion shtesë brenda afatit kohor të arsyeshëm që specifikon.

Neni 57

Konfidencialiteti i kërkesave për ekstradim

Shteti Palë i kërkuar mban konfidencial faktin dhe thelbin e kërkesës, veçse në masën e nevojshme për të ekzekutuar kërkesën. Nëse Shteti Palë i kërkuar nuk mund të përmbushë kërkesën për konfidencialitet, ai njofton menjëherë Shtetin Palë të kërkuar. Shteti Palë kërkuar vendos nëse kërkesa gjithsesi duhet të ekzekutohet.

Neni 58

Kërkesa konfliktuale

1. Nëse ekstradimi ose dorëzimi kërkohet njëkohësisht nga më shumë se një Shtet Palë ose gjykatë apo tribunal penal kompetent ndërkombëtar, ose për të njëjtin krim ose për krime të ndryshme, Shteti Palë i kërkuar merr vendimin e tij duke pasur parasysh çdo detyrim në lidhje me epërsinë e juridiksionit sipas një instrumenti ligjor ndërkombëtar detyrues për Shtetin Palë të kërkuar.

2. Në mungesë të këtij detyrimi, Shteti Palë i kërkuar merr vendimin e tij bazuar në rrethana të rëndësishme siç janë rëndesa relative dhe vendi i kryerjes së krimeve, datat përkatëse të kërkesave, shtetësia e personave të kërkuar, shtetësia e viktimës ose viktimave dhe mundësia e ekstradimit vijues në një Shtet tjetër Palë.

Neni 59

Arresti i përkohshëm

1. Shteti Palë i kërkuar, me kërkesë të Shtetit Palë kërkuar dhe pasi të jetë bindur se e kërkojnë rrethanat dhe për shkak të emergjencës, mund të mbajë në burg një person për të cilin kërkohet ekstradimi dhe që ndodhet në territorin e tij, apo të marrë masa të tjera të përshtatshme për të siguruar praninë e tij/saj në procedurën e ekstradimit.

2. Kërkesa për arrestin e përkohshëm përmban:

a) informacionin e përmendur në nenin 56, paragrafi 2, nënparagrafët "a" deri në "c", nëse kërkohet sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar;

b) një përshkrim të krimit për të cilin bëhet kërkesa dhe faktet përkatëse;

c) një deklaratë të ekzistencës së dokumenteve të përmendura në nenin 56;

d) një deklaratë se do të pasojë një kërkesë zyrtare për ekstradimin e personit të kërkuar.

3. Shteti Palë i kërkuar, pa vonesë, njofton Shtetin Palë kërkuar mbi rezultatin e trajtimit të kërkesës për arrestin e përkohshëm.

4. Arresti i përkohshëm ndërpritet nëse brenda një periudhe prej 60 ditësh pas arrestimit të personit të kërkuar, Shteti Palë i kërkuar nuk ka marrë asnjë kërkesë zyrtare për ekstradim. Personi mund të lirohet përkohësisht në çdo moment, rast në të cilin Shteti Palë i kërkuar merr çdo masë që e konsideron të nevojshme për të parandaluar arratisjen e personit të kërkuar.

5. Përfundimi e arrestit të përkohshëm sipas paragrafit 4 nuk cenon riarrestimin dhe ekstradimin vijues të personit që kërkohet, nëse Shteti Palë i kërkuar më pas merr kërkesën zyrtare për ekstradim.

Neni 60

Marrja parasysh e afateve të ndalimit

Shteti Palë kërkues inkurajohet, në masën më të madhe të mundshme sipas legjislacionit të tij të brendshëm, të marrë parasysh të gjitha periudha e ndalimit që lindin nga ekzekutimi i një kërkesë ekstradimi në Shtetin Palë të kërkuar kur përcakton kohën e plotë të ndalimit që duhet të vuhet në Shtetin Palë kërkues si pasojë e dhënies së një dënimi me burg ose urdhër ndalimi.

Neni 61

Dorëzimi i personit që do të ekstradohet

1. Nëse pranohet kërkesa, Shteti Palë kërkues dhe Shteti Palë i kërkuar konsultohen dhe bien dakord për vendin dhe datën e dorëzimit. Shteti Palë kërkues informohet për kohëzgjatjen e mbajtjes së personit të kërkuar të ndaluar për qëllim të dorëzimit.

2. Sipas dispozitave të paragrafit 3, nëse personi i kërkuar nuk është marrë në dorëzim në datën e caktuar, ai mund të lirohet në fund të 30 ditëve dhe në çdo rast ai lirohet në fund të 45 ditëve, nëse Shteti Palë kërkues nuk e ka specifikuar ndryshe. Shteti Palë i kërkuar mund të refuzojë të ekstradojë personin për të njëjtin krim.

3. Nëse rrethanat përtej kontrollit të tij e pengojnë një Shtet Palë që të dorëzojë ose të marrë në dorëzim një person që do të ekstradohet, ai njofton Shtetin tjetër Palë. Shtetet Palë në fjalë konsultohen dhe mund të bien dakord për një datë të re për dorëzimin dhe zbatohen dispozitat e paragrafit 2.

Neni 62

Dorëzimi i shtyrë ose i përkohshëm

1. Shteti Palë i kërkuar, pasi të marrë vendimin e tij për kërkesën për ekstradim, mund të shtyjë dorëzimin e personit të kërkuar me qëllim që ai person të mund të ndiqet penalisht nga ai Shtet Palë ose, nëse personi është dënuar tashmë, me qëllim që ai person të mund të vuajë dënimin në territorin e atij Shteti Palë për një krim të ndryshëm nga ai për të cilin është kërkuar ekstradimi.

2. Shteti Palë i kërkuar, në vend që të shtyjë dorëzimin, mund të dorëzojë përkohësisht personin e kërkuar në Shtetin Palë kërkues në përputhje me kushtet që do të përcaktohen me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Shteteve Palë.

Neni 63

Procedurat e ekstradimit të thjeshtuar

Nëse ekstradimi i një personi të kërkuar nuk është parashikuar qartazi në legjislacionin e Shtetit Palë të kërkuar dhe nëse personi i kërkuar bie dakord për ekstradimin, në përputhje me procedurën sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë të kërkuar, Shteti Palë i kërkuar mund të pranojë ekstradimin me anë të një procedure të thjeshtuar.

Neni 64

Dorëzimi i pronës

1. Shteti Palë i kërkuar, në masën që e lejon legjislacioni i tij i brendshëm dhe me kërkesë të Shtetit Palë kërkues, sekuestron dhe dorëzon pronën:

a) që mund të kërkohej si provë; ose
b) që është fituar si rezultat i krimit dhe që në momentin e arrestimit rezulton në posedim të personit të kërkuar ose zbulohet rrjedhimisht.

2. Prona e përmendur në paragrafin 1 dorëzohet edhe nëse ekstradimi, pasi është pranuar, nuk mund të ekzekutohet për shkak të vdekjes, zhdukjes ose arratisjes së personit të kërkuar.

3. Kur prona e përmendur në paragrafin 1 është objekt i sekuestrimit ose konfiskimit në territorin e Shtetit Palë të kërkuar, ky i fundit, në lidhje me proceset penale në pritje, e mban ose e dorëzon atë përkohësisht ose e dorëzon me kushtin që të kthehet.

4. Çdo të drejtë që Shteti Palë i kërkuar ose palë e tretë që vepron në mirëbesim mund të ketë fituar mbi pronën e përmendur në paragrafin 1 ruhet në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin e tij të brendshëm. Nëse ekzistojnë këto të drejta, Shteti Palë kërkuar i kthen pronën Shtetit Palë të kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur dhe pa tarifë në përfundim të procesit.

Neni 65

Transiti i personave që do të ekstradohen dhe transiti i personave të ekstraduar

1. Në rastet kur një person do të ekstradohet në një Shtet Palë përmes territorit të një Shteti tjetër Palë, Shteti Palë tek i cili personi do të ekstradohet i kërkon me shkrim Shtetit tjetër Palë që të lejojë transitin e atij personi përmes territorit të tij. Kjo nuk vlen kur përdoret transporti ajror dhe nuk është planifikuar asnjë ulje në territorin e Shtetit tjetër Palë.

2. Me marrjen e një kërkesë të tillë, Shteti Palë i kërkuar e trajton këtë kërkesë në përputhje me procedurat që parashikon legjislacioni i tij i brendshëm. Shteti Palë i kërkuar miraton kërkesën me shpejtësi nëse kjo nuk cenon interesat e tij thelbësore.

3. Shteti Palë i transimit sigurohet që të ketë dispozita ligjore për të mundësuar mbajtjen e personit të ndaluar gjatë transimit.

4. Në rastin e një uljeje të paplanifikuar në tokë, Shteti Palë, me kërkesë të oficerit shoqërues, mund të mbajë personin të ndaluar për një periudhë kohore në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, në pritje për të marrë kërkesën për transit, sipas paragrafit 1.

5. Transiti i personit të ekstraduar nuk do të bëhet përmes një territori ku ka arsye për të besuar që jeta e personit mund të kërcënohet, ose nëse ekziston një risk i lartë i shkeljes së të drejtave të tij për shkak të racës, seksit, ngjyrës, paafësisë mendore ose fizike, orientimit seksual, fesë, kombësisë, origjinës etnike, bindjeve politike ose përkatësisë në një grup të caktuar social.

6. Shteti Palë mund të refuzojë kërkesën për të lejuar transitin e një shtetasi përmes territorit të tij.

PJESA V

TRANSFERIMI I PERSONAVE TË DËNUAR

Neni 66

Objekti i pjesës V dhe përkufizimet që lidhen me transferimin e personave të dënuar

1. Kur është e mundur, dhe në përputhje me parimet themelore të legjislacionit të brendshëm, një person i dënuar në një Shtet Palë për një krim për të cilin zbatohet kjo Konventë mund të transferohet në një Shtet tjetër Palë për të vuajtur dënimin që është dhënë ndaj tij. Transferimi gjithashtu është i mundur kur dënimi është dhënë për një krim për të cilin zbatohet kjo Konventë në kombinim me krime të tjera.

2. Për qëllime të kësaj pjese të Konventës:

a) “Shtet Palë administrues” është Shteti Palë ku personi i dënuar mund të transferohet ose është transferuar që të vuajë dënimin e tij;

b) “Vendim gjyqësor” është një vendim ose një urdhër gjykate që vendos një dënim në lidhje me të cilin nuk ka më mundësi për zgjidhje ligjore të zakonshme dhe prandaj është i formës së prerë;

c) “Dënim” është çdo ndëshkim ose masë që përfshin heqjen e lirisë të urdhëruar nga një gjykatë për kryerjen e një krimi për të cilin zbatohet kjo Konventë;

d) “Shtet Palë dënues” është Shteti Palë ku është dhënë dënimi.

Neni 67

Kushtet për transferim

1. Transferimi mund të kërkohet nga Shteti Palë dënues apo Shteti Palë administrues.
2. Personi i dënuar mund t'i shprehë Shtetit Palë dënues ose Shtetit Palë administrues interesin e tij për t'u transferuar sipas kësaj Konvente.
3. Një person i dënuar mund të transferohet sipas kësaj Konvente vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) personi është shtetas i Shtetit administrues sipas rastit në përputhje me nenin 9;
 - b) vendimi gjyqësor është i formës së prerë;
 - c) në momentin e marrjes së kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende për të vuajtur të paktën gjashtë muaj nga dënimi apo masa e dënimit nuk është me afat të caktuar;
 - d) Pa cenuar nenin 71 dhe nenin 72, personi i dënuar ose përfaqësuesi ligjor i tij, kur Shteti Palë dënues ose Shteti palë administrues e konsiderojnë të nevojshme për shkak të moshës apo gjendjes fizike apo mendore, japin pëlqimin për transferimin;
 - e) Shteti Palë dënues dhe Shteti Palë administrues bien dakord për transferimin.
4. Në raste përjashtimore, Shtetet Palë mund të bien dakord për transferimin edhe nëse koha e vuajtur nga personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 3, nënparagrafi "c".
5. Nëse një Shtet Palë i cili e kushtëzon transferimin e personave të dënuar me ekzistencën e një marrëveshjeje merr një kërkesë për transferimin e një personi të dënuar nga një Shtet tjetër Palë me të cilin nuk ka marrëveshje për transferimin e personave të dënuar, ai do të konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për transferimin e personave të dënuar në lidhje me krime për të cilat Shteti Palë i parë zbaton këtë Konventë.

Neni 68

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Çdo person i dënuar për të cilin mund të zbatohet kjo Konventë informohet nga Shteti Palë dënues për thelbin e kësaj Pjese të Konventës.
2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur Shtetit Palë dënues interesin për t'u transferuar sipas kësaj Konvente, ky Shtet Palë informon për këtë Shtetin Palë administrues sapo të jetë e mundur pasi vendimi gjyqësor të ketë marrë formë të prerë.
3. Informacioni përmban:
 - a) emrin, datën dhe vendin e lindjes dhe sipas rastit në përputhje me nenin 9, shtetësinë e personit të dënuar;
 - b) adresën e personit të dënuar, nëse ka, në Shtetin Palë administrues;
 - c) një parashtrim të fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi;
 - d) natyrën, kohëzgjatjen dhe datën e fillimit të dënimit;
 - e) periudhën e dënimit të vuajtur tashmë dhe zbritje të tjera të dënimit sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë dënues;
 - f) nëse është e nevojshme, një deklaratë që kërkesa për transferim është bërë sipas kësaj Konvente.
4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur Shtetit Palë administrues interesin e tij për t'u transferuar bazuar në këtë Konventë, Shteti Palë dënues, me kërkesë të Shtetit Palë administrues, i jep këtij të fundit informacionin e përmendur në paragrafin 3.
5. Personi i dënuar informohet me shkrim mbi çdo veprim të ndërmarrë nga Shteti Palë dënues ose nga Shteti Palë administrues, sipas dispozitave të këtij neni, si edhe për çdo vendim të marrë nga secili prej Shteteve Palë në lidhje me kërkesën për transferim.

Neni 69

Kërkesat, përgjigjet dhe dokumentet mbështetëse

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet ndaj tyre bëhen me shkrim.

2. Shteti Palë i kërkuar informon menjëherë Shtetin Palë kërkues për vendimin e tij nëse e pranon apo jo transferimin e kërkuar dhe, me kërkesë, për arsyet e refuzimit kur është e mundur dhe e përshtatshme.

3. Shteti Palë administrues, nëse i kërkohet nga Shteti Palë dënues, i vë atij në dispozicion:

a) një dokument apo deklaratë e cila tregon që personi i dënuar është shtetas i Shtetit Palë administrues, sipas rastit në përputhje me nenin 9;

b) një kopje të legjislacionit të brendshëm përkatës të Shtetit Palë administrues i cili parashikon se veprimet apo mosveprimet për të cilat është dhënë dënimi në Shtetin Palë dënues përbëjnë krim sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë administrues, apo do të përbënin krim nëse do të ishin kryer në territorin e tij;

c) informacion mbi mënyrën e ekzekutimit të dënimit në rastin e transferimit dhe, sipas rastit, kopje të dispozitave përkatëse të legjislacionit të tij të brendshëm për vazhdimësinë ose konvertimin e dënimeve;

d) informacion për lirimin me kusht ose para kohe dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit të tij të brendshëm.

4. Nëse kërkohet transferimi, Shteti Palë dënues i jep Shtetit Palë administrues dokumentet e mëposhtme përveçse kur Shteti Palë i kërkuar ka treguar tashmë që nuk do të pranojë transferimin:

a) një kopje të njësuar të vendimit gjyqësor dhe një kopje të dispozitave përkatëse të legjislacionit të brendshëm mbi të cilat bazohet;

b) një deklaratë që tregon periudhën e dënimit të vuajtur tashmë, përfshirë informacionin për paraburgimin, uljen e dënimit dhe çdo faktor tjetër të rëndësishëm për ekzekutimin e dënimit;

c) pa cenuar nenet 71 dhe 72, një deklaratë me shkrim që përmban pëlqimin për transferimin të përmendur në nenin 67, paragrafi 3, nënparagrafi “d”;

d) sipas rastit, çdo raport mjekësor apo social mbi personin e dënuar, informacion mbi trajtimin e tij në Shtetin Palë dënues, dhe çdo rekomandim për trajtimin e tij të mëtejshëm në Shtetin Palë administrues.

5. Secili Shtet Palë mund të kërkojë ndonjë nga dokumentet apo deklaratat e përmendura në paragrafët 3 ose 4 më lart përpara se të bëhet një kërkesë për transferim apo të merret një vendim për pranimin apo jo të transferimit.

Neni 70

Pëlqimi dhe verifikimi i tij

1. Shteti Palë dënues sigurohet që personi të cilit i kërkohet të japë pëlqimin për transferimin në përputhje me nenin 67, paragrafi 3, nënparagrafi “d” ta bëjë këtë me dëshirë dhe me dijeni të plotë për pasojat ligjore përkatëse. Procedura për dhënien e pëlqimit rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë dënues.

2. Shteti Palë dënues i jep mundësi Shtetit Palë administrues që të verifikojë nëpërmjet një nëpunësi konsullor apo një nëpunësi tjetër për të cilin është rënë dakord me Shtetin Palë administrues nëse pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përmendura në paragrafin 1.

Neni 71

Personat që janë larguar nga Shteti Palë dënues

1. Nëse një shtetas i një Shteti Palë është subjekt i një dënimi, Shteti Palë dënues mund t’i kërkojë Shtetit të shtetësisë që të marrë përsipër ekzekutimin e dënimit sipas rrethanave të mëposhtme:

a) kur personi në fjalë është arratisur ose përndryshe është kthyer në Shtetin e shtetësisë së tij duke qenë në dijeni të procesit penal që zhvillohet kundër tij në Shtetin Palë dënues;

b) kur personi është arratisur ose përndryshe është kthyer në Shtetin e shtetësisë së tij duke qenë në dijeni të vendimit gjyqësor të nxjerrë kundër tij në Shtetin Palë dënues.

2. Më kërkesë të Shtetit Palë dënues, Shteti Palë administrues, përpara se të marrë dokumentet që mbështesin kërkesën ose përpara se të merret vendimi për atë kërkesë, mund ta arrestojë personin e dënuar apo të marrë çdo masë tjetër për t’u siguruar që personi i dënuar të qëndrojë në territorin e tij në pritje të vendimit për kërkesën. Kërkesa për masa të përkohshme do të shoqërohet me informacionin e

përmendur në nenin 69, paragrafi 3. Arrestimi i personit të dënuar sipas këtij paragrafi nuk e rëndon pozitën e tij penale.

3. Në lidhje me këtë nen, transferimi i administrimit të dënimit nuk kërkon pëlqimin e personit të dënuar.

4. Asnjë parashikim i këtij neni nuk e detyron Shtetin e shtetësisë që të marrë përsipër ekzekutimin e dënimeve sipas rrethanave të përshkruara në këtë nen.

Neni 72

Personat e dënuar subjekt i urdhrit të dëbimit apo deportimit

1. Shteti Palë administrues, me kërkesë të Shtetit Palë dënues, sipas dispozitave të këtij neni, mund të pranojë transferimin e personit të dënuar pa pëlqimin e atij personi, kur dënimi i dhënë për këtë të fundit, ose një vendim administrativ në vijim të atij dënimi përmban një urdhër dëbimi apo deportimi ose ndonjë masë tjetër si rezultat i të cilës ai person nuk do të lejohet më të qëndrojë në territorin e Shtetit Palë dënues pasi të jetë liruar nga burgu.

2. Shteti Palë administrues nuk e pranon transferimin për qëllimet e paragrafit 1 përpara se të ketë marrë parasysh mendimin e personit të dënuar.

3. Për qëllimet e këtij neni, Shteti Palë dënues i jep Shtetit Palë administrues:

a) një deklaratë që përmban mendimin e personit të dënuar në lidhje me transferimin e propozuar dhe;

b) një kopje të urdhrit të dëbimit ose deportimit ose çdo urdhër tjetër që ka efektin që personi i dënuar të mos lejohet më të qëndrojë në territorin e Shtetit Palë dënues pasi të jetë liruar nga burgu.

4. Çdo person i transferuar sipas dispozitave të këtij neni nuk do të ndiqet penalisht, dënohet apo ndalohet për qëllim të ekzekutimit të një dënimi ose urdhër ndalimi, për ndonjë krim të kryer përpara transferimit të tij të ndryshëm nga ai për të cilin është dhënë dënimi që do të ekzekutohet, dhe as nuk do t'i kufizohet liria personale për ndonjë arsye tjetër, përveçse në rastet e mëposhtme:

a) Kur këtë e autorizon Shteti Palë dënues:

i. kërkesa për autorizim dorëzohet e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe një procesverbal të ligjshëm të çdo deklarami të bërë nga personi i dënuar;

ii. autorizimi jepet kur krimi për të cilin kërkohet do të ishte vetë objekti i ekstradimit sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë dënues ose nëse ekstradimi do të përjashtohet vetëm për shkak të masës së dënimit;

b) Kur personi i dënuar, pasi ka pasur mundësinë që të largohet nga territori i Shtetit Palë administrues, nuk është larguar brenda 45 ditëve të lirimit të tij përfundimtar, ose kur personi është kthyer në atë territor pasi është larguar.

5. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 4, Shteti Palë administrues mund të marrë çdo masë të nevojshme sipas legjislacionit të tij të brendshëm, duke përfshirë procesin gjyqësor *in absentia*, për të parandaluar çdo pasojë ligjore nga parashkrimi.

6. Asnjë parashikim i këtij neni nuk e detyron një Shtet Palë që të marrë përsipër ekzekutimin e dënimeve sipas rrethanave të përshkruara në këtë nen.

Neni 73

Efekti i transferimit për Shtetin Palë dënues

1. Marrja në dorëzim e personit të dënuar nga autoritetet e Shtetit Palë administrues ka efektin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit në Shtetin Palë dënues.

2. Shteti Palë dënues nuk mund ta ekzekutojë më dënimin nëse Shteti Palë administrues vlerëson se ekzekutimi i dënimit ka përfunduar.

Neni 74

Efekti i transferimit për Shtetin Palë administrues

1. Autoritetet kompetente të Shtetit Palë administrues ose:

a) vazhdojnë ekzekutimin e dënimit menjëherë apo nëpërmjet një urdhri gjyqësor apo administrativ, në përputhje me nenin 50; ose

b) e konvertojnë dënimin, nëpërmjet një procedure gjyqësore apo administrative, në një vendim të atij Shteti Palë duke zëvendësuar në këtë mënyrë masën e dënimit të caktuar në Shtetin Palë dënues me një masë dënimi të parashikuar nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë administrues për të njëjtin krim, në përputhje me nenin 68.

2. Çdo Shtet mund të përjashtojë zbatimin e një prej procedurave të përmendura në paragrafin 1 në lidhje me Shtetet e tjera Palë duke njoftuar autoritetet qendrore të Shteteve Palë, ose nëse plotësohen kushtet e nenit 85, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, Shtetin e përcaktuar që të ofrojë mbështetje shtesë të përkohshme.

3. Shteti Palë administrues, nëse kërkohet, informon Shtetin Palë dënues përpara transferimit të personit të dënuar në lidhje me procedurën e përmendur në paragrafin 1 të cilën do të ndjekë.

4. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë administrues, dhe vetëm ai Shtet Palë është kompetent për të marrë të gjitha vendimet e duhura.

5. Cilido Shtet Palë, i cili në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm nuk mund të ndjekë një prej procedurave të përmendura në paragrafin 1 për të ekzekutuar masat e vendosura në territorin e një Shteti tjetër Palë ndaj personave të cilët për shkak të gjendjes mendore nuk janë penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale dhe i cili është i përgatitur që t'i pranojë këta persona për trajtim të mëtejshëm, mund të tregojë për procedurat që do të ndjekë në këto rrethana duke informuar autoritetet qendrore të Shteteve Palë, ose nëse plotësohen kushtet e nenit 85, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, Shtetin e përcaktuar që do të ofrojë mbështetje shtesë të përkohshme.

Neni 75

Ekzekutimi i vazhduar

1. Në rastin e ekzekutimit të vazhduar, natyra ligjore dhe kohëzgjatja e dënimit të dhënë nga Shteti Palë dënues janë të detyrueshme për Shtetin Palë administrues.

2. Nëse dënimi i përmendur në paragrafin 1 për nga natyra apo kohëzgjatja nuk është në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë administrues, apo nëse kështu e kërkon legjislacioni i tij i brendshëm, ai Shtet Palë, me anë të një urdhri gjyqësor apo administrativ mund të përshtatë masën e dënimit të dhënë për ekzekutim me ndëshkimin apo masën e parashikuar në legjislacionin e tij të brendshëm për të njëjtin krim. Sipas natyrës së tij, ndëshkimi apo masa, për sa është e mundur, përputhet me masën e dënimit të dhënë me vendimin e dënimit që do të ekzekutohet. Ai nuk do të rëndojë, sa i përket natyrës apo kohëzgjatjes, masën e dënimit të vendosur në Shtetin Palë dënues dhe as nuk do të tejkalojë dënimin maksimal të parashikuar në legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë administrues.

Neni 76

Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohet procedura e parashikuar në legjislacionin e brendshëm të Shtetit Palë administrues. Gjatë konvertimit të dënimit, autoritetet kompetente:

a) janë të detyruara t'i referohen gjetjeve për faktet përderisa ato paraqiten në mënyrë të shprehur apo të nënkuptuar në vendimin gjyqësor të dhënë në Shtetin Palë dënues;

b) nuk mund të konvertojnë një masë dënimi me heqje lirie në një sanksion monetar;

c) zbresin periudhën e plotë të heqjes së lirisë të vuajtur tashmë nga personi i dënuar;

d) nuk e rëndojnë pozitën penale të personit të dënuar;

e) nuk janë të detyruara të zbatojnë ndonjë dënim minimal që legjislacioni i brendshëm i Shtetit Palë mund të parashikojë për krimin ose krimet e kryera.

2. Nëse procedura e konvertimit bëhet pas transferimit të personit të dënuar, Shteti Palë administrues e mban atë person në burg ose përndryshe siguron praninë e personit të dënuar në Shtetin Palë administrues në pritje të rezultatit të asaj procedure.

Neni 77

Rishikimi i vendimit gjyqësor

Vetëm Shteti Palë dënues ka të drejtë të vendosë për çfarëdolloj kërkesë për rishikim të vendimit gjyqësor të dhënë në Shtetin Palë dënues.

Neni 78

Përfundimi i ekzekutimit

Shteti Palë administrues e ndërpret ekzekutimin e dënimit sapo informohet nga Shteti Palë dënues mbi çfarëdo vendimi apo mase si rezultat i së cilës dënimi nuk është më i ekzekutueshëm.

Neni 79

Informacion mbi ekzekutimin

Shteti Palë administrues i jep Shtetit Palë dënues informacion në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

- a) kur vlerëson se ekzekutimi i dënimit ka përfunduar;
- b) nëse personi i dënuar është arratisur nga vendi i ndalimit përpara përfundimit të ekzekutimit të dënimit; ose
- c) nëse Shteti Palë dënues kërkon një raport të veçantë.

Neni 80

Transiti i personave të dënuar

1. Një Shtet Palë, në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm, miraton kërkesën për transitin e një personi të dënuar përmes territorit të tij nëse kërkesa bëhet nga një Shtet tjetër Palë dhe ai Shtet ka rënë dakord me Shtetin tjetër Palë ose me një Shtet të tretë që ta transferojë atë person për në ose nga territori i tij.

2. Një Shtet Palë mund të refuzojë të miratojë transitin nëse personi i dënuar është një nga shtetasit e tij.

3. Kërkesat për transit dhe përgjigjet komunikohen përmes rrugëve të komunikimit të përmendura në nenin 21, paragrafët 1 ose 2.

4. Një Shtet Palë mund të pranojë kërkesën për kalimin transit të një personi të dënuar përmes territorit të tij të bërë nga një Shtet i tretë nëse ai Shtet ka rënë dakord me Shtetin tjetër Palë që ta transferojë atë person për në ose nga territori i tij.

5. Shtetit Palë që i kërkohet të pranojë transitin mund të mbajë personin e dënuar të ndaluar vetëm për atë kohë sa është e nevojshme që të kalojë transit përmes territorit të tij.

6. Shtetit Palë që i kërkohet të pranojë transitin mund t'i kërkohet të japë garanci që personi i dënuar nuk do të ndiqet penalisht, ose, përveç parashikimit në paragrafin 5, nuk do të ndalohet ose përndryshe nuk do t'i nënshtrohet kufizimit të lirisë së tij në territorin e Shtetit Palë të transimit për ndonjë krim të kryer ose dënim të dhënë përpara largimit të tij nga territori i Shtetit Palë dënues.

7. Kërkesa për transit nuk nevojitet nëse transporti bëhet me rrugë ajrore mbi territorin e një Shteti Palë dhe nuk është planifikuar zbritje. Një Shtet Palë mund të kërkojë që të njoftohet për transitin përmes territorit të tij duke njoftuar autoritetet qendrore të Shteteve Palë ose, nëse plotësohen kushtet në nenin 85, paragrafët 2 dhe 3, Shtetin e caktuar për të dhënë mbështetje të përkohshme shtesë.

8. Në rastin e uljes së paplanifikuar, neni 65, paragrafi 4, zbatohet *mutatis mutandis*.

PJESA VI
VIKTIMAT, DËSHMITARËT, EKSPERTËT DHE PERSONAT E TJERË

Neni 81

Përkufizimi i viktimave

1. Pa cenuar përkufizimet më të gjera sipas legjislacionit të brendshëm dhe për qëllime të kësaj pjese të Konventës:

a) “Viktima” janë personat fizikë që kanë pësuar dëmtim si pasojë e kryerjes së një krimi për të cilin zbatohet kjo Konventë;

b) “Viktima” mund të jenë organizatat ose institucionet që kanë pësuar dëme të drejtpërdrejta ndaj pasurisë së tyre që i kushtohet fesë, arsimit, artit, shkencës ose qëllimeve të bamirësisë, si edhe monumenteve të tyre historike, spitaleve dhe vendeve dhe objekteve të tjera për qëllime humanitare.

2. Ky nen zbatohet në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Neni 82

Mbrojtja e viktimave, dëshmitarëve, ekspertëve dhe të tjerëve

1. Çdo Shtet Palë merr masat e duhura që të sigurojë mbrojtjen efektive nga hakmarrja ose kërcënimi i mundshëm, sidomos keqtrajtimi i viktimave, dëshmitarëve dhe sipas rastit të të afërmeve dhe përfaqësuesve të tyre, të ekspertëve, si edhe të personave të tjerë që marrin pjesë ose bashkëpunojnë për hetimin, ndjekjen penale, ose proces tjetër brenda objektit të kësaj Konvente.

2. Masat e parashikuara në paragrafin 1, pa cenuar të drejtat e të pandehurit, sidomos të drejtën për proces të rregullt mund të përfshijnë:

a) krijimin e procedurave për mbrojtjen fizike të personave të përmendur në paragrafin 1, siç janë, aq sa është e nevojshme dhe e mundshme, sistemimin e tyre dhe kur është e përshtatshme, lejimin e mosnxjerrjes së informacionit ose të kufizimeve ndaj nxjerrjes së informacionit në lidhje me identitetin dhe vendndodhjen e këtyre personave;

b) krijimin e procedurave për të lejuar dëshmitarët dhe ekspertët që të japin dëshmi në mënyrë të tillë që garanton sigurinë e tyre dhe, sipas rastit, mirëqenien fizike dhe psikologjike dhe privatësinë, siç është lejimi i përdorimit të teknologjive të komunikimit.

3. Shtetet Palë vlerësojnë mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve apo rregulimeve me Shtete të tjera Palë për sistemimin e personave të përmendur në paragrafin 1.

Neni 83

Të drejtat e viktimave

1. Çdo Shtet Palë, sipas legjislacionit të tij të brendshëm, merr masat e nevojshme për të siguruar që viktima e një krimi për të cilin Shteti Palë zbaton këtë Konventë të ketë të drejtën të kërkojnë dëmshpërblim që sipas rastit përbëhet, por jo vetëm, nga kthimi, kompensimi ose rehabilitimi sa kohë që ose:

a) krimi është kryer në çdo territor nën juridiksionin e atij Shteti Palë; ose

b) ai Shtet Palë ushtron juridiksionin e tij mbi krimin.

2. Çdo Shtet Palë, sipas legjislacionit të brendshëm, krijon procedura, sipas rastit, për të lejuar viktimat që të marrin pjesë dhe të bëjnë të mundur që mendimet dhe shqetësimet e viktimave të paraqiten dhe të merren parasysh në fazat e duhura të procesit penal kundër autorëve të dyshuar në mënyrë të tillë që nuk cenon të drejtat e të pandehurit.

3. Çdo Shtet Palë, në masën me të madhe të mundshme të parashikuar në legjislacionin e tij të brendshëm dhe nëse kërkohet, zbaton një vendim gjyqësor ose urdhër në proces penal, të nxjerrë sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Palë kërkuar, për të siguruar kthimin, kompensimin ose rehabilitimin për viktimat e krimeve për të cilat Shteti i parë Palë zbaton këtë Konventë.

PJESA VII RREGULLIME INSTITUCIONALE

Neni 84

Mbledhja e Shteteve Palë

1. Mbledhja e parë e Shteteve Palë thirret me propozimin e të paktën një të tretës së Shteteve Palë në fund të pesë viteve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente ose dy vjet pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, cilado qoftë më vonë. Pas kësaj, Mbledhjet e Shteteve Palë mund të thirren me propozimin e të paktën një të tretës së Shteteve Palë ose siç vendos Mbledhja e Shteteve Palë.

2. Në Mbledhjet e Shteteve Palë të përmendura në paragrafin 1, Shtetet Palë mund:

a) të shqyrtojnë çdo ndryshim të Konventës të propozuar sipas nenit 87 dhe çdo aneks shtesë të propozuar në përputhje me nenin 88;

b) të marrin parasysh çdo tekst tjetër autentik të Konventës në një gjuhë zyrtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara;

c) të shqyrtojnë krijimin e rregullimeve institucionale efikase dhe të organizuara që janë të nevojshme për të zbatuar Konventën, sidomos veprimtaritë e parashikuara në nenin 85.

3. Pavarësisht dhe pa cenuar takimet e Mbledhjes së Shteteve Palë me prezencë, për të promovuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme dhe komunikimin dhe konsultimin përkatës ndërmjet Shteteve Palë, në masën më të madhe të mundshme dhe sipas rastit do të përdoren të gjitha mjetet në dispozicion për komunikimin elektronik dhe videokonferencën.

Neni 85

Mbështetja e përkohshme

1. Mbretëria e Holandës do të përgatitë dhe vendosë në dispozicion informacion për qëllime operacionale, të përmendura në nenin 21, paragrafi 4, sa më shpejt që të jetë e mundur, deri në dy vjet pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë.

2. Mbretëria e Holandës mund të ofrojë mbështetje shtesë të përkohshme, sidomos:

a) përgatitja dhe vënia në dispozicion e informacionit për qëllime operacionale, të përmendura në nenin 22, paragrafi 2, nenin 40, paragrafi 4, nenin 42, paragrafi 3, nenin 74, paragrafi 2 dhe paragrafi 5, dhe nenin 80, paragrafi 7;

b) bërja e rregullimeve për Mbledhjen e parë të Shteteve Palë, të përmendur në nenin 84, paragrafi 1.

3. Mbështetja shtesë e përkohshme e përmendur në paragrafin 2 mund të jepet në varësi të disponueshmërisë së kontributeve financiare vullnetare nga Shtetet Palë për mbulimin e kostove përkatëse.

PJESA VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 86

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Shtetet Palë bëjnë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente nëpërmjet negocimit.

2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy apo më shumë Shteteve Palë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente, që nuk mund të zgjidhet me anë të negocimit gjashtë muaj nga data e kërkesës për zgjidhje, me kërkesë të një prej këtyre Shteteve Palë do të paraqitet për arbitrazh. Nëse gjashtë muaj pas datës së kërkesës për arbitrazh këto Shtete Palë nuk janë në gjendje të bien dakord mbi organizimin e arbitrazhit, cilado nga këto Shtete Palë mund ta referojë mosmarrëveshjen te Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me kërkesë në përputhje me Statutin e Gjykatës.

3. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit, apo aderimit në këtë Konventë mund të deklarojë se nuk e konsideron që paragrafi 2 i këtij neni është i detyrueshëm për atë Shtet. Paragrafi 2 nuk është i detyrueshëm për Shtetet e tjera Palë në lidhje me çdo Shtet Palë që ka bërë një rezervë të tillë.

Neni 87

Ndryshime të Konventës

1. Në fund të periudhës pesë vjeçare nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente ose pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, cilado qoftë më vonë, një Shtet Palë mund të propozojë ndryshimin e kësaj Konvente.

2. Çdo propozim për ndryshim i komunikohet Depozitarit, i cili e qarkullon propozimin te të gjitha Shtetet Palë me qëllim që të shqyrtohet dhe të vendoset mbi propozimin në takimin e radhës së Mbledhjes së Shteteve Palë. Depozitari gjithashtu i komunikon ndryshimet e propozuara Shteteve aderuese dhe Palëve nënshkruese të kësaj Konvente.

3. Shtetet Palë bëjnë çdo përpjekje për të arritur një marrëveshje me konsensus për çdo ndryshim të propozuar të kësaj Konvente. Nëse janë shteruar të gjitha përpjekjet për konsensusin, dhe nuk është arritur marrëveshje, si alternativë e fundit, ndryshimi do të kërkojë miratimin me votë nga shumica prej tre të katërtave të Shteteve Palë të pranishme dhe që votojnë në Mbledhjen e Shteteve Palë të përmendur në paragrafin 2. Për qëllime të këtij neni, Shtetet Palë të pranishme dhe që votojnë janë Shtetet Palë të pranishme dhe që votojnë pro ose kundër.

4. Depozitari i komunikon çdo ndryshim të miratuar të Konventës të gjitha Shteteve Palë, Shteteve aderuese dhe Palëve nënshkruese të kësaj Konvente për ratifikim, pranim, miratim ose aderim.

5. Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve, ato janë të detyrueshme për ato Shtete Palë që i kanë pranuar. Dispozitat e kësaj Konvente dhe çdo ndryshim i mëparshëm është i detyrueshëm për Shtetet e tjera Palë që i kanë pranuar ato.

6. Çdo ndryshim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të tre muajve pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit. Për çdo Shtet Palë që ratifikon, pranon ose miraton ndryshimin pse aderon në të pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ndryshimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të tre muajve nga data e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit nga ky Shtet.

Neni 88

Miratimi i anekseve shtesë

1. Çdo Shtet Palë, në çdo moment, në fund të pesë viteve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente ose pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit or aderimit, cilado qoftë më vonë, mund të propozojë anekse shtesë të kësaj Konvente që përmbajnë një ose më shumë krime të cilat nuk janë renditur në ndonjë aneks tjetër.

2. Anekset shtesë propozohen dhe miratohen dhe hyjnë në fuqi sipas procedurës në nenin 87, paragrafët 2 deri në 6.

Neni 89

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet, më 14 dhe 15 shkurt 2024, në Pallatin e Paqes në Hagë. Më pas, ajo do të mbetet e hapur për nënshkrim nga 19 shkurt 2024 deri më 14 shkurt 2025 në Shërbimin Publik Federal të Punëve të Jashtme, Tregtisë së Jashtme dhe Bashkëpunimi për Zhvillim i Mbretërisë së Belgjikës në Bruksel.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit pranimit apo miratimit, depozitohen pranë Depozitarit.

3. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga çdo Shtet. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Depozitarit.

Neni 90

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit në fund të tre muajve pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit.
2. Për çdo Shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Konventë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit në fund të tre muajve pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit nga ky Shtet.
3. Çdo deklaram i përmendur në nenin 2, paragrafi 2, i bërë në momentin e ratifikimit, pranimi, ose miratimit apo aderimit në këtë Konventë hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Konventës për Shtetin në fjalë, në përputhje me paragrafët 1 ose 2.
4. Çdo deklaram i përmendur në nenin 2, paragrafi 2, i bërë në momentin e ratifikimit, pranimi, ose miratimit apo aderimit, por përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Konventës për Shtetin në fjalë, në përputhje me paragrafët 1 ose 2, ose nëse Konventa ka hyrë tashmë në fuqi në lidhje me këtë Shtet, në ditën e parë të muajit në fund të tre muajve nga data e marrjes së deklaramit nga Depozitari.
5. Kjo Konventë zbatohet për çdo kërkesë të paraqitur pas datës së hyrjes në fuqi të Konventës, ose nëse ndodh më vonë, të aneksit përkatës, për Shtetet Palë të interesuara, sidomos nëse veprimet apo mosveprimet përkatëse kanë ndodhur përpara asaj date. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose sipas rastit, në momentin e njoftimit të Depozitarit se do të zbatojë gjithashtu një ose më shumë anekse të Konventës, mund të depozitojë te Depozitari një deklaratë që rezervon të drejtën për të mos e zbatuar këtë Konventë për kërkesat që lidhen me veprime ose mosveprime që kanë ndodhur përpara datës të treguar nga ai Shtet Palë, me kusht që kjo datë të mos jetë më vonë se data e hyrjes në fuqi të Konventës ose aneksit përkatës për atë Shtet Palë.

Neni 91

Zbatim i përkohshëm

1. Çdo Shtet, në momentin e nënshkrimit, mund të deklarojë që do të zbatojë përkohësisht këtë Konventë ose ndonjë pjesë të saj, në pritje të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë Shtet.
2. Kërkesat për bashkëpunim nga Shtetet që zbatojnë Konventën përkohësisht mund të refuzohen nga Shtetet Palë të cilat nuk kanë bërë deklaratën sipas paragrafit 1 përpara se të bëhen Shtet Palë i Konventës.
3. Çdo Shtet Palë mund të ndërpresë zbatimin e përkohshëm të kësaj Konvente duke njoftuar me shkrim Depozitarin. Përfundimi e zbatimit të përkohshëm të kësaj Konvente hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari. Përfundimi nuk ndikon te detyrimet e atij Shteti sipas Konventës në lidhje me kërkesat sipas kësaj Konvente të bëra përpara ndërprerjes së zbatimit të përkohshëm.

Neni 92

Rezervat

1. Për këtë Konventë nuk mund të bëhen rezerva të ndryshme nga ato që janë parashikuar në këtë nen.
2. Një Shtet, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimi ose miratimit apo aderimit në Konventë, mund të formulojë një rezervë për nenin 39, nenin 40 ose nenin 42, si edhe një rezervë të parashikuar shprehimisht në nenin 86, paragrafi 3, dhe nenin 90, paragrafi 5.
3. Një Shtet, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimi ose miratimit apo aderimit në Konventë, mund të formulojë një rezervë, për periudha të rinovueshme tre vjeçare, bazuar në shkaqe që parashikon legjislacioni i tij i brendshëm dhe në përputhje me detyrimet e tij sipas të drejtës ndërkombëtare, që kufizon vendosjen e juridiksionit të tij sipas nenit 8, paragrafi 3.

4. Çdo Shtet që ka formuluar një rezervë sipas paragrafëve 2 ose 3, në çdo moment mund ta tërheqë atë rezervë duke njoftuar Depozitarin.

Neni 93 **Tërheqja**

1. Një Shtet Palë mund të tërhiqet nga kjo Konventë duke njoftuar Depozitarin.
2. Tërheqja hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari, ose në një datë të mëvonshme që mund të jetë specifikuar në njoftimin e tërheqjes.
3. Tërheqja nuk prek detyrimet e atij Shteti sipas Konventës në lidhje me kërkesat sipas kësaj Konvente të bëra përpara datës së hyrjes në fuqi të tërheqjes në përputhje me paragrafin 2.
4. Një Shtet Palë mund të tërheqë deklaratën e përmendur në nenin 2, paragrafi 2, duke njoftuar Depozitarin. Kjo tërheqje hyn në fuqi në përputhje me procedurën e përmendur në paragrafët 2 dhe 3.

Neni 94 **Depozitari dhe gjuhët**

1. Mbretëria e Belgjikës vepron si Depozitari i kësaj Konvente dhe çdo ndryshimi të saj.
2. Varianti origjinal i kësaj Konvente ku tekstet në gjuhën Angleze, Frënge dhe Spanjolle janë njësoj autentike, si edhe tekste të tjera autentike të kësaj Konvente të përmendura në nenin 84, paragrafi 2, nënparagrafi “b”, do të depozitohen te Depozitari.
3. Depozitari:
 - a) ruan tekstet origjinale dhe çdo tekst tjetër autentik të kësaj Konvente të përmendur në nenin 84 paragrafi 2, nënparagrafi “b”;
 - b) përgatit kopje të njësuara të teksteve origjinale dhe çdo teksti tjetër autentik të kësaj Konvente të përmendur në nenin 84, paragrafi 2, nënparagrafi “b”, dhe ia përcjell ato Shteteve Palë, dhe me kërkesë, Shteteve që kanë të drejtë të bëhen Palë të kësaj Konvente;
 - c) regjistron këtë Konventë pranë Sekretariatit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në përputhje me nenin 102 të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
4. Depozitari njofton Shtetet Palë, Shtetet aderuese dhe Shtetet nënshkruese, për:
 - a) çdo deklaratë që shtrin objektin e kësaj Konvente të krimi ose krimet e përmendura në një prej anekseve të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 2, paragrafi 2;
 - b) çdo njoftim që përkufizon termin “shtetas” të bërë në përputhje me nenin 9;
 - c) çdo njoftim në lidhje me përcaktimin e një autoriteti qendror në përputhje me nenin 20, paragrafi 5;
 - d) çdo njoftim në lidhje me rrugët e komunikimit, në përputhje me nenin 21, paragrafi 2;
 - e) çdo njoftim në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 86, paragrafi 3;
 - f) Depozitimin e një instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi apo aderimi në një ndryshim të kësaj Konvente dhe datat e hyrjes në fuqi të atij ndryshimi për Shtetet Palë të interesuara në përputhje me nenin 87, paragrafi 6;
 - g) Depozitimin e një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi në përputhje me nenin 89;
 - h) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 90, paragrafi 1;
 - i) pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Shtetet Palë të interesuara, në përputhje me nenin 90, paragrafi 2;
 - j) çdo deklaratë që shpreh zbatimin e përkohshëm të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 91, paragrafi 1;
 - k) çdo njoftim në lidhje me ndërprerjen e zbatimit të përkohshëm të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 91, paragrafi 3;
 - l) çdo rezervë të bërë në përputhje me nenin 92;
 - m) çdo njoftim për tërheqje në përputhje me nenin 93, paragrafët 1 dhe 4.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Konventë.

BËRË në Lubjanë, në ditën e 26-të të majit 2023.

ANEKSE

ANEKSI A KRIMET E LUFTËS

Përveç “akteve” të përmendura në nenin 5, (4(e)), kjo Konventë zbatohet edhe për “aktet” e mëposhtme në lidhje me Shtetet Palë që kanë bërë një njoftim sipas nenit 2(2):

- a) përdorimi i helmit ose i armëve të helmuara;
- b) përdorimi i gazeve asfiksuese, helmuese ose të tjera, dhe të gjitha lëngjeve, materialeve ose pajisjeve të ngjashme;
- c) përdorimi i plumbave shpërthyes ose rrafshues lehtësisht në trupin e njeriut, të tilla si plumba me mbështjellë të fortë që nuk mbulon plotësisht bërthamën ose është shpuar me prerje.

ANEKSI B KRIMET E LUFTËS

Përveç “akteve” të përmendura në nenin 5(4(b)), dhe nenin 5(4(e)) kjo Konventë zbatohet edhe për “aktet” e mëposhtme në lidhje me Shtetet Palë që kanë bërë një njoftim sipas nenit 2(2): përdorimi i armëve që përdorin agjentë mikrobikë ose të tjerë biologjikë, ose toksina, cilado qoftë origjina ose metoda e prodhimit të tyre.

ANEKSI C KRIMET E LUFTËS

Përveç “akteve” të përmendura në nenin 5(4(b)), dhe nenin 5(4(e)) kjo Konventë zbatohet edhe për “aktet” e mëposhtme në lidhje me Shtetet Palë që kanë bërë një njoftim sipas nenit 2(2): përdorimi i armëve efekti kryesor i të cilave është të plagosin me fragmente që në trupin e njeriut i shmangen zbulimit me rreze X.

ANEKSI D KRIMET E LUFTËS

Përveç “akteve” të përmendura në nenin 5(4(b)), dhe nenin 5(4(e)) kjo Konventë zbatohet edhe për “aktet” e mëposhtme në lidhje me Shtetet Palë që kanë bërë një njoftim sipas nenit 2(2): përdorimi i armëve me laser të krijuara në mënyrë specifike funksioni i vetëm i të cilave është luftimi ose, si pjesë e kësaj, shkaktimi i verbërimit të përhershëm të të parit të papërforcuar, pra të syrit të lirë ose syrit me pajisje korrigjuese të pamjes.

ANEKSI E KRIMET E LUFTËS

Përveç “akteve” të përmendura në nenin 5(4(e)), kjo Konventë zbatohet edhe për “aktin” e mëposhtëm në lidhje me Shtetet Palë që kanë bërë një njoftim sipas nenit 2(2): Përdorimi me dashje i urisë së civilëve si një metodë lufte duke i privuar ata nga objektet e domosdoshme për mbijetesën e tyre, sidomos pengimi me dashje i furnizimeve;

ANEKSI F TORTURA

1. Përveç listës së krimeve të përmendura në nenin 5, kjo Konventë zbatohet edhe për krimin e torturës në lidhje me Shtetet Palë që kanë bërë një njoftim sipas nenit 2(2).

2. Për qëllime të kësaj Konvente, termi “torturë” do të thotë çdo akt me anë të të cilit ndaj një personi shkaktohet me dashje dhimbje ose vuajtje e rëndë, qoftë fizike ose mendore, për qëllime të tilla si marrja prej tij ose një personi të tretë e informacionit ose një pohimi, duke e dënuar për një akt që ka kryer ose dyshohet të ketë kryer ai ose një person i tretë, ose duke e frikësuar ose detyruar atë ose një person të tretë, ose për çdo arsye bazuar në diskriminim të çdo lloji, kur kjo dhimbje ose vuajtje shkaktohet nga ose me nxitje të ose me pëlqimin apo lejin e një nëpunësi publik ose personi tjetër që vepron në cilësi zyrtare. Nuk përfshin dhimbje ose vuajtje që shkaktohet nga, është e natyrshme ose është pasojë e dënimeve të ligjshme.

ANEKSI G ZHDUKJA E DETYRUAR

1. Përveç krimeve të përmendura në nenin 5, kjo Konventë zbatohet edhe për krimin e zhdukjes së detyruar në lidhje me Shtetet Palë që kanë bërë një njoftim sipas nenit 2.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente “zhdukje e detyruar” do të thotë arrestimi, ndalimi apo rrëmbimi i personave ose çdo formë tjetër e heqjes së lirisë nga agjentët e Shtetit ose nga persona apo grupe të personave me autorizimin, mbështetjen apo pranimin në heshtje të Shtetit, të ndjekur nga refuzimi për ta pranuar këtë heqje të lirisë, apo nga fshehja e informacionit mbi fatin, apo vendndodhjen e personit të zhdukur, me qëllimin për ta nxjerrë këtë person jashtë mbrojtjes së ligjit.

ANEKSI H KRIMI I AGRESIONIT

1. Përveç krimeve të përmendura në nenin 5, kjo Konventë zbatohet edhe për krimin e agresionit në lidhje me Shtetet Palë që kanë bërë një njoftim sipas nenit 2(2).

2. Për qëllim të kësaj Konvente, “krim agresioni” do të thotë planifikimi, përgatitja, fillimi ose ekzekutimi, nga një person në pozitë që mund të ushtrojë kontroll mbi ose të drejtojë një aksion politik apo ushtarak të një Shteti për një akt agresioni që për nga natyra, rëndesa dhe shkalla përbën haptazi një shkelje të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

3. Për qëllim të paragrafit 2 “akt agresioni” do të thotë përdorimi i forcës së armatosur nga një Shtet kundër sovranitetit, integritetit territorial apo pavarësisë politike të një Shteti tjetër, ose në ndonjë mënyrë tjetër jo në përputhje me Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Secili prej akteve të mëposhtme, pavarësisht nga shpallja e një lufte, në përputhje me rezolutën 3314 (XXIX) të 14 dhjetorit 1974 të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, cilësohet si akt agresioni:

a) pushtimi ose sulmi nga forcat e armatosura të një Shteti në territorin e një Shteti tjetër, ose çdo pushtim ushtarak, edhe pse i përkohshëm, që rezulton nga ky pushim ose sulm, apo çdo aneksim i territorit të Shtetit tjetër ose pjesëve të tij me anë të përdorimit të forcës;

b) bombardimi nga forcat e armatosura të një Shteti kundër territorit të një Shteti tjetër ose përdorimi i çdo arme nga një Shtet kundër territorit të një Shteti tjetër;

c) bllokada e porteve ose brigjeve të një Shteti nga forcat e armatosura të një Shteti tjetër;

d) sulmi nga forcat e armatosura të një Shteti mbi forcat tokësore, detare, apo ajrore, apo flotën detare apo ajrore të një Shteti tjetër;

e) përdorimi i forcave të armatosura të një Shteti që janë brenda territorit të një Shteti tjetër me marrëveshje të Shtetit pritës, në kundërshtim me kushtet e parashikuara në marrëveshje ose çdo shtyrje e pranisë së tyre në territor përtej përfundimit të marrëveshjes;

f) veprimi i një Shteti duke lejuar që territori i tij, i cili është vënë në dispozicion të një Shteti tjetër, të përdoret nga Shteti tjetër për të kryer një akt agresioni kundër një Shteti të tretë;

g) dërgimi nga ose në emër të një Shteti i bandave, grupeve të armatosura, mercenarëve apo guerilëve, që kryejnë kundër një Shteti tjetër akte të forcës së armatosur të cilat janë kaq të rënda sa konsiderohen akte të përmendura më sipër, ose përfshirja e tij e konsiderueshme në këto akte.